

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 5992
E hënë, 3 shkurt 2020
çmimi 0.40 €

Lideri i BDI-së uron botuesin Mavraj për 20-vjetorin e "Epokës së re"



FAQE 6
Shkup, 3 shkurt 2020
Lideri i BDI-së uron botuesin Mavraj për 20-vjetorin e "Epokës së re".

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

LËVIZJA VETËVENDOSJE (LV) DHE LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS (LDK) KANË ZYRTARIZUAR TË DIELËN MARRËVESHJEN PËR BASHKËQEVERISJE

QEVERIA KURTI VOTOHET SOT



I nominuari për kryeministër, Albin Kurti, sot (e hënë), në orën 11:00, do ta kërkojë votën e Kuvendit të Kosovës për përbërjen e kabinetit të vet qeveritar. Qeveria Kurti pritet t'i ketë votat e mjaftueshme pas marrëveshjes për bashkëqeverisje

që Lëvizja Vetëvendosje (LV) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) kanë zyrtarizuar të dielën. Sipas kësaj marrëveshjeje, qeveria e re do t'i ketë 15 ministri, dy zëvendëskryeministra dhe rreth 33 zëvendësministra. Marrëveshja në

mes të dy partive parasheh që dy partitë të kenë nga gjashtë ministri, nga një zëvendëskryeministër, kurse kryeparlamentari do t'i takojë LDK-së. Çështja e postit të presidentit është lënë të diskutohet më vonë

OPINION

SFERAT E FUSHAVE VEPRUESE TEK ELEKTRONET

F. 11

Shkruan: Naim KRASNIQI, fizikan



AKTUALE

NË LUMBARDH TË DEÇANIT SHËNOHET 30-VJETORI I NISMËS PËR PAJTIMITIN E GJAQEVE

F. 6

DIALOGU KOSOVË - SERBI, NËN LLUPËN E SHBA-SË DHE BE-së

F. 7

EKONOMI



APELOHET PËR KUJDES NDAJ IMPORTIT TË MALLRAVE ME ORIGJINË AZIATIKE

F. 9

PATUNDSHMËRITË, SEKTORI MË TËRHEQËS PËR DIASPORËN

F. 8

KULTURË

KUR HESHTJA NDIHET ME SY

F. 15

Nga: Ajet SHALA



SPORT

DOSHLAKU: LARGIMI NGA FERONIKELI, I VËSHITËRË

F. 18

INTERVISTË ME PUBLICISTIN, NJËRIN NDËR PESË NISMËTARËT E PAJTIMIT TË GJAQEVE, LULËZIM ETEMAJ



'LËVIZJA E PAJTIMIT TË GJAQEVE NË KOSOVË 1990-1990', MONOGRAFI HISTORIKE

Të dielën, më 2 shkurt 1990, u bënë 30 vjet të fillimit të pajtimit të gjaqeve. Në shënim të këtij përvjetori, publicisti Lulëzim Etemaj, një ndër pesë nismëtarët e saj, e ka nxjerrë nga shtypi, pikërisht në këtë datë, mono-

grafinë "Lëvizja e Pajtimit të Gjaqeve në Kosovë 1990-1990". Në fakt, ky është aktiviteti i vetëm shënues i këtij përvjetori, duke qenë se nga institucionet e shtetit nuk është paraparë të ketë ndonjë organizim për këtë

Lëvizje, e cila ia arriti t'i pajtojë mbi 1 000 gjaqe. Historiku i pajtimit të gjaqeve, shtirja, drejtimi, efektet e tij primare edhe në zhvillimet e mëpastajme historike të Kosovës janë përfshirë në librin e Etemajt

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht-Tetovë
Çurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Maqedonia e Veriut në pritje të datës së bisedimeve me BE-në

Pas mbylljes së kontestit të emrit me Greqinë në qershor të vitit 2018, dhe vlerësimeve pozitive se janë përmbushur edhe kriteret e tjera, Maqedonia e Veriut është në pritje të nisjes së bisedimeve të anëtarësimit me BE-në

SHKUP, 2 SHKURT - Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria duhet t'i nisin negociatat e anëtarësimit me Bashkimin Evropian, ka deklaruar ambasadori i Italisë në Shkup, Carlo Romeo. Në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë", ambasadori italian thotë se qëndrimi i vendit që përfaqëson është se paralelisht me metodologjinë apo reformat brenda BE-së, të zhvillohet edhe procesi i çeljes së negociatave me këto dy vende.

Ai thotë se Italia është për një proces më efikas dhe dinamik të zgjerimit dhe jo për ndërlikimin e procedurave.

"Politika e zgjerimit edhe më tej është fundamentale për Bashkimin Evropian. BE-ja duhet të jetë më e përgatitur për zgjerime të reja. Konsiderojmë se

metodologjia e re duhet të realizohet paralelisht me reformat brenda unionit, pra, mund të zhvillohet paralelisht me procesin e hapjes së bisedimeve, që sipas natyrës, është një proces i gjatë që bazohet në sistemin merit të çdo shteti potencial për anëtarësim në BE. Ne, nuk jemi për komplikimin e procesit, por të kemi një proces më dinamik më efektiv. Nuk duam që debati për mekanizmin e ri të shndërrohet në kusht të ri që do të çonte në shtyrjen e sërishme të negociatave me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë", ka deklaruar ambasadori italian, Carlo Romeo.

Ambasadori italian ka thënë se pritjet e tij janë që data e bisedimeve për Shkupin dhe Tiranën të jepen në mbledhjen e Këshillit Evropian në mars.

"Pozicioni i Italisë është shumë i qartë dhe transparent. Ne shpresojmë se Maqedonia e Veriut shumë shpejt do t'i nisë bisedimet me BE-në. Besojmë se kjo do të ndodhë në samitin e ardhshëm të Këshillit të BE-së, në mars. Në samitin e majit në Zagreb mes BE-së dhe Ballkanit Perëndimor, nuk do të ketë vendim për hapjen e negociatave pasi ky samit nuk do të mbahet për këtë çështje. Pra, ne shpresojmë se kjo do të ndodhë në mbledhjen e Këshillit në mars. Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria kanë përmbushur të gjitha kriteret për nisjen e bisedimeve të anëtarësimit. Kjo duhet të ndodhte në tetor të vitit të kaluar, por fatkeqësisht të gjithë ishim të dëshpëruar që kjo nuk u bë", ka deklaruar ambasadori italian, duke bërë të ditur se javën që vjen pritet të publikohet edhe metodologjia e re për zgjerimin e BE-së.

Drejtuesit e institucioneve të Maqedonisë së Veriut janë optimistë për një vendim pozitiv, por tani janë të përmbajtur nga parashikimet, në veçanti pas samitit të tetorit të vitit të kaluar kur

Maqedonisë së Veriut, siç thonë padrejtësisht nuk iu dha data e nisjes së bisedimeve.

"Pas asaj që ka ndodhur në tetor, unë tash nuk bëj premtime, ato ia lë Bashkimin Evropian pasi përgjegjësia është e tyre. Ne premtojmë se do të vazhdojmë të punojmë për samitin e Këshillit Evropian më 26 mars. Do të ketë një raport të jashtëzakonshëm në shkurt, i ndryshëm nga ai i rregullti që është në prill dhe ky raport do të merret si bazë për ndonjë vendim në mars", ka deklaruar zëvendëskryeministri për çështje evropiane, Bujar Osmani.

Partitë politike ndërkohë kanë qëndrime të ndryshme mbi pritjet e tyre nga zhvillimet në mars dhe në maj. Ish-kryeministri Zoran Zaev, kryetar i Lidhjes Social Demokratike që është në qeveri, thotë se kësaj radhe vendimi do të jetë pozitiv.

"Një orë e më parë presim datën për fillimin e bisedimeve. Në samitin e Bashkimin Evropian, të Këshillit Evropian u tha se kjo do të ndodhë në muajin maj, në samitin e Zagrebit. Unë besoj në vendim

pozitiv, pra çelja e negociatave duhet të ndodhë sa më shpejt që të jetë e mundur", ka deklaruar Zaevi. Por, nga opozita maqedonase janë pesimiste për ndonjë vendim pozitiv, për shkak të siç thonë, ngecjes së proceseve, në veçanti në gjyqësor për shkak të shumë aferave në të cilat, sipas saj janë të përfshirë zyrtarë të lartë.

"Për fat të keq Maqedonia nuk do të marrë datën, nuk do të marrë vendim pozitiv nga ana e institucioneve evropiane deri sa të mos ketë një kthesë pozitive serioze në politikën e qeverisjes aktuale", ka deklaruar zëdhënësi i VMRO-DPMNE-së, Naum Stoilkovski.

Maqedonia e Veriut, statusin e shtetit kandidat e ka marrë që në vitin 2005, por nisja e bisedimeve të anëtarësimit ishte kushtëzuar me zgjidhjen e kontestit të emrit me Greqinë. Pas mbylljes së këtij problemi në qershor të vitit 2018, dhe vlerësimeve pozitive se janë përmbushur edhe kriteret e tjera, vendi është në pritje të nisjes së bisedimeve të anëtarësimit me BE-në.



Presidenti i PE-së në Tiranë, takon krerët e shtetit

TIRANË, 2 SHKURT - Presidenti i Parlamentit Evropian, David Sassoli sot (e hënë) do të mbërrijë në Shqipëri. Ndërkohë mësohet se Sassoli në orën 14:45, do të jetë i pranishëm në sallën e seancave plenare, ku do të pritet nga kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi.

Pas takimit, me Ruçin në orën 15:15, presidenti Sassoli do të për-

shëndesë në seancën plenare të Kuvendit të Shqipërisë.

Në Tiranë Sassoli do të qëndrojë dy ditë, ku do të takohet me presidentin Ilir Meta, kryeministrin Edi Rama, kryetarin e Kuvendit Gramoz Ruçi, kryetarin e PD-së dhe të LSI-së.

Në qendër të vizitës do të jetë çështja e negociatave. Sassoli është

shprehur optimist se negociata do të hapen para Samitit të Zagrebit. Sipas axhendës, Sassoli sot (e hënë) në orën 11:00 takohet me ambasadorin e BE-së në Tiranë, Luigi Soreca, në orën 11:30 takohet me kryeministrin Edi Rama, kurse konferenca me gazetarë mbahet në orën 12:15.

Në orën 14:45 takohet me

kryetarin e Kuvendit, Gramoz Ruçi dhe kryetarët e grupeve parlamentare. Në orën 15:15 Sassoli do të mbajë një fjalë në seancën plenare, kurse në orën 16:00 takim me presidentin Ilir Meta.

Ndërkaq, nesër (e martë) do të takohet me Lulzim Bashën dhe Monika Kryemadhin në selinë e PD-së.



Intervistë me publicistin, njërin ndër pesë nismëtarët e pajtimit të gjaqeve, Lulëzim Etemaj

'Lëvizja e Pajtimit të Gjaqeve në Kosovë 1990-1990', monografi historike



Të dielën, më 2 shkurt 1990, u bënë 30 vjet të fillimit të pajtimit të gjaqeve. Në shënim të këtij përvjetori, publicisti Lulëzim Etemaj, një ndër pesë nismëtarët e saj, e ka nxjerrë nga shtypi, pikërisht në këtë datë, monografinë "Lëvizja e Pajtimit të Gjaqeve në Kosovë 1990-1990". Në fakt, ky është aktiviteti i vetëm shënues i këtij përvjetori, duke qenë se nga institucionet e shtetit nuk është paraparë të ketë ndonjë organizim për këtë Lëvizje, që ia arriti t'i pajtojë mbi 1 000 gjaqe. Historiku i pajtimit të gjaqeve, shtrirja, drejtimi, efektet e tij primare edhe në zhvillimet e mëpastajme historike të Kosovës janë përfshirë në librin e Etemajt. "Monografia e ka për bazë konceptin e paraqitjes së historikut të pajtimit të gjaqeve. Nisma, zhvillimi i tij i shpejtë, pavarësisht prej pengesave të forcave serbe, nga aksioni në lëvizje gjithëpopullore, shtrirja e tij në nivel Kosove, tubimet më të mëdha, gjaqet e para të falura dhe tri kuvendet, janë disa nga segmentet e tij", ka thënë Etemaj në këtë intervistë dhënë për "Epokën e re"

herë mirënjohjen dhe falënderimin publik, si një nga pesë nismëtarët, por edhe si qytetar ndaj të gjithë atyre që na i hapen jo vetëm dyert e kullave dhe shtëpive, por edhe të zemrës. Ata iu përgjigjën pozitivisht ftesës sonë për pajtim, hoqën dorë nga gjakmarrja dhe çfarëdo hakmarrje tjetër në interes të Kosovës.

"Epokën e re": *Ka pasur paraqitje të ndryshme në media dhe aty-këtu në ndonjë libër dhe versione, po ashtu të shumta, përkthimi me historikun e pajtimit të gjaqeve në vitin 1990-1991 në Kosovë. A mund të llogaritet në përmbyse të këtyre versioneve?*
Etemaj: Qëllimi i bërjes së monografisë nuk është as përmbyseja e as rrënim. Si fati i njëjës, si i tjetrës, po ashtu edhe i ngritjes së një versioni të qëndrueshëm, varet plotësisht nga përmbyseja e parakushteve që shtrou historiografia e mirëfilltë shkencore: mbështetja në fakte konkrete të qëndrueshme, e që në këtë rast janë të dorës së parë.

"Epokën e re": *Në këtë aspekt, kush është ai që mund t'i vihet në barrë drejtimi i Lëvizjes së Pajtimit të Gjaqeve?*

Etemaj: Nuk kishte një njeri të vetëm, as si nismëtar dhe as si drejtues. Kishte një trup drejtues në nivel të Kosovës. Ajo përbëhej nga pesë nismëtarët e pajtimit të gjaqeve: Have Shala, Myrvete Dreshaj, Adem Grabovci, Brahim Dreshaj dhe Lulëzim Etemaj. Për këtë kishte vendosur Kuvendi i Lëvizjes së Pajtimit të Gjaqeve, i mbajtur më datë 19 maj 1990 në Strellc të Deçanit ku, krahas përfaqësuesve të shumtë të këshillave të pajtimit, pjesëmarrës në këtë kuvend kanë qenë edhe Anton Çetta, Zekeria Cana etj. Çdo vendim, ashtu si kur ishte vendosur të fillohej me pajtimin e gjaqeve, merrej pas

diskutimeve të shumta dhe në pajtim të plotë të çdonjërit prej tyre. Pikërisht kjo frymë demokratike është një nga parakushtet themelore të suksesit të saj. E konsideroj të rëndësishë së veçantë mbështetjen e madhe të Anton Çettës, të profesorëve dhe intelektualëve të tjerë, si dhe të qëndruarit e tij krahas nesh. Me njohjen e gjerë të kulturës dhe traditës shqiptare si dhe urtësinë e tij, prof. Anton Çetta ia ka rritur peshën dhe respektin Lëvizjes së Pajtimit të Gjaqeve. Kjo ka ndikuar pozitivisht edhe në suksesin e saj. Kishte një gërshetim të shkëlqyeshëm të energjisë, vizionit, vendosmërisë dhe përkushtimit rinor, me urtësinë dhe maturinë e tij.

"Epokën e re": *Libri shihet të jetë i pasur me ngjarje, data të shumta, materiale faktografike, fotografi, emra të atyre që vepruan për pajtimin e gjaqeve si dhe atyre që falen gjaqe.*

Etemaj: Monografia e ka për bazë konceptin e paraqitjes së historikut të pajtimit të gjaqeve. Nisma, zhvillimi i tij i shpejtë, pavarësisht prej pengesave të forcave serbe, nga aksioni në lëvizje gjithëpopullore, shtrirja e tij në nivel Kosove, tubimet më të mëdha, gjaqet e para të falura dhe tri kuvendet, janë disa nga segmentet e tij. Mospërfshirja e çfarëdo emri, pajtimi të gjakut, plage, ngatërrese, tubimi a zhvillimi, nuk është bërë me qëllim nënvlerësimi. E vlerësoj lart çdo veprim, çdo akt si dhe çdo person, që me angazhimin e tij ka bërë që sukcesi i Lëvizjes së Pajtimit të Gjaqeve të jetë madhështor.

"Epokën e re": *Unike, e papërsëritshme, madhështore, janë disa nga vlerësimet që i bëhen Lëvizjes së Pajtimit të Gjaqeve në Kosovë.*

Etemaj: Nuk gjendet edhe një rast i vetëm në historinë e popullit

tonë kur brenda një viti të jenë falur 1 169 gjaqe. Që të gjitha faljet janë bërë mbi bazën vullnetare, pa asnjë imponim, pa dënim apo dëmshpërblim. Ku femra shqiptare jo vetëm që ka qenë veprimtare e pajtimit, por e ka thënë edhe fjalën e saj, duke marrë pjesë në vendim apo dhe vendosur vetë për faljen e gjakut. Si rrjedhojë e kësaj përfshirjeje, ka plot oda shqiptare dhe mjedise patriarkale ku femra shqiptare ka hyrë për herë të parë në oda të tilla, të dedikuara sipas traditës ekskluzivisht për burra. Nuk më është e njohur të ketë pasur një lëvizje të tillë të pajtimit të gjaqeve as te popujt e tjerë evropianë.

"Epokën e re": *Cilat janë vendimet më të veçanta të kuvendeve të Lëvizjes së Pajtimit të Gjaqeve?*

Etemaj: Përderisa Kuvendi I e rikonfirmoi drejtimin e Lëvizjes nga pesë nismëtarët e saj, Kuvendi II caktoi periudhën njëvjeçare 1990-1991 si periudhë veprimi të saj, të realizimit të misionit human dhe kombëtar si dhe të përfundimit të saj. Origjinali i procesverbalit tetëfaqsh të Kuvendit I, ashtu si dhe shumë dokumente dhe fotografi të tjera, botohet për herë të parë në libër.

"Epokën e re": *Shteti i Kosovës, asnjë institucion i tij, nuk e ka shënuar sot 30-vjetorin e Lëvizjes së Pajtimit të Gjaqeve.*

Etemaj: Kjo indiferencë nuk e zbeh aspak vlerën historike të Lëvizjes së Pajtimit të Gjaqeve. Është në përputhje të plotë me mosrespektimin e vlerave tona kulturore historike. Në cilin drejtim qëndron shoqëria dhe shteti ynë më mirë? Në asnjërin! Madje as sa i përket luftës çlirimtare të UÇK-së, heronjve, dëshmorëve, përgjithësisht viktimave të gjenocidit të kryer nga shteti i Serbisë në Kosovë.

EPOKA ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 2 SHKURT -

"Epokën e re": *Cili ishte qëndrimi i Serbisë karshi pajtimit të gjaqeve në Kosovë?*

Etemaj: 30 vjet më parë Kosova ishte e pushtuar. Si nismëtarët, veprimtarët ashtu dhe ata që falnin gjaqe nuk shiheshin me indiferencë apo tolerancë nga forcat e Serbisë. Përkundrazi. Ndiqeshin, kërcënoheshin, mbylleshin e torturoheshin. Por, Serbia nuk ia arriti ta ndalë pajtimin e shqiptarëve. Nuk mundi t'i ndalë as tubimet e tyre madhështore për faljen e gjaqeve. Pjesëmarrja masive në to tregonte mosbindjen shqiptare. Guximin kundërshtues ndaj saj. Prandaj u organizuan tubime madhështore, ku morën pjesë

mbi gjysmë milioni pjesëmarrës, shqiptarë nga të gjitha trojet, siç ishte tubimi të Verrat e Llukës, i mbajtur më 1 maj 1990. Aty u falen dhjetëra gjaqe, plagë e ngatërresa.

"Epokën e re": *30 vjet më pas, po dilni me monografinë "Lëvizja e Pajtimit të Gjaqeve në Kosovë 1990-1991". Pse e gjithë kjo vonesë?*

Etemaj: Është fatkeqësisht në përputhje me natyrën shqiptare. Vonesa është një nga anët tona të errëta si komb. Pritja ka qenë që një monografi të tillë ta bëjnë njerëzit që i kanë profesion shkencat historike. Mungesa e një libri të tillë, të vlefshëm për historiografinë shqiptare, por edhe evropiane, ka qenë për mua motivi kryesor për ta shkruar këtë libër. Ka qenë gjithësesi edhe obligim imi që ta shpreh edhe një

Lëvizja Vetëvendosje (LV) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) kanë zyrtarizuar të dielën marrëveshjen për bash

Qeveria Kurti

I nominuari për kryeministër, Albin Kurti, sot (e hënë), në orën 11:00, do ta kërkojë votën e Kuvendit të Kosovës për përbërjen e kabinetit të vet qeveritar. Qeveria Kurti pritet t'i ketë votat e mjaftueshme pas marrëveshjes për bashkëqeverisje që Lëvizja Vetëvendosje (LV) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) kanë zyrtarizuar të dielën. Sipas kësaj marrëveshjeje, qeveria e re do t'i ketë 15 ministri, dy zëvendëskryeministra dhe rreth 33 zëvendësministra. Marrëveshja në mes të dy partive parasheh që dy partitë të kenë nga gjashtë ministri, nga një zëvendëskryeministër, kurse kryeparlamentari do t'i takojë LDK-së. Çështja e postit të presidentit është lënë të diskutohet më vonë



EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 2 SHKURT - Lëvizja Vetëvendosje (LV) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) të dielën kanë nënshkruar marrëveshjen për koalicionin e ardhshëm qeverisës në Kosovë. Kurse sot (e hënë), në orën 11:00, i nominuari për kryeministër, Albin Kurti, para Kuvendit do ta paraqesë përbërjen e kabinetit të vet qeveritar dhe do ta kërkojë votën e deputetëve për miratim. Qeveria Kurti do t'i ketë 15 ministri, dy zëvendëskryeministra dhe 33 zëvendësministra. Nga gjashtë ministri dhe nga një zëvendësministër do t'i kenë LV-ja dhe LDK-ja, kurse tri ministri do t'u takojnë minoriteteve. Pas nënshkrimit të marrëveshjes për bashkëqeverisje, liderët e dy partive në një konferencë për medie të mbajtur në ambientet e Kuvendit të Kosovës kanë njoftuar ndarjen e përgjegjësive, duke treguar se të dy partitë do t'i kenë nga gjashtë ministri dhe nga një zëvendësministër, kurse tri ministri do t'i udhëheqin minoritetet. "Ne sot u takuam me kryetarin Isa Mustafa dhe u pajtuam që të takohemi edhe nesër për ta zgjedhur qeverinë e re dhe në këtë mënyrë ta

jetësojmë ndryshimin e madh politik të 6 tetorit. Ne tashmë kemi nënshkruar marrëveshjen dhe jemi marrë vesh për të gjitha, përveç për harmonizimin e programit, edhe për ndarjen e përgjegjësive në kuadër të qeverisë së re, ku ne do të bashkëqeverisim", ka thënë lideri i LV-së, Albin Kurti. Ai e ka arsyetuar rritjen e numrit të ministreve nga 12 sa ishin pajtuar fillimisht, në 15 sosh. "Synimi ynë që t'i kemi 12 ministri ka qenë synim i drejtë, por kemi thënë se është një tendencë e jona dashamirëse për të kursyer sa më shumë. Mirëpo, në anën tjetër, kur kemi analizuar strukturat e ministrive përkatëse, krijimi i disa super ministrive është dëshmuar se është kosto më e madhe sesa t'i kemi 12 ministri. Pra, nëse ne nuk do të bënim një gjë të tillë, atëherë do të zvarritej për një vit reduktimi në 12 ministri. Më mirë ta bëjmë reduktimin më të shpejtë në 15 sosh sesa të presim më gjatë për reduktimin në 12", ka thënë Kurti, duke treguar se në seancën e radhës LV-ja do ta propozojë për kryetar të Kuvendit një deputet të LDK-së. Ndërsa kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Isa Mustafa, ka thënë se të dy partitë dëshirojnë që qeveria të jetë e suksesshme. "Ne kemi

arritur marrëveshje dhe vlerësojmë se është marrëveshje në të mirë të Kosovës. Është në interes të ndryshimeve që domosdoshmërisht duhet të ndodhin në vendin tonë. Vlerësoj se marrëveshja është rezultat i një mirëkuptimi dhe një pune të përbashkët mjaft të gjatë me liderin e LV-së, z. Kurti, po dhe me bashkëpunëtorët e tij", ka thënë ai, duke shtuar se dëshiron që kjo qeveri të jetë e suksesshme dhe t'i realizojë pritjet e qytetarëve. Marrëveshja për bashkëqeverisje LV-LDK nuk përmban çështjen e postit të presidentit, siç kishte kërkuar LDK-ja prej përfundimit të zgjedhjeve. Lideri i LDK-së, Isa Mustafa, ka thënë se për këtë

çështje së bashku me Kurtin do të bisedojnë kur të vijë koha. "Sa i përket presidentit nuk është pjesë e marrëveshjes që sot e kemi nënshkruar. Do të jetë çështje për të cilën do të pajtohemi unë dhe Kurti si lider politikë dhe do ta zgjedhim edhe atë çështje në kohën që është e domosdoshme", ka thënë Mustafa. Pas nënshkrimit, Këshilli i Përgjithshëm i LDK-së i ka dhënë mbështetje unanime marrëveshjes, ndërsa LV-ja ka organizuar referendumin për strukturat e saj për ta mbështetur marrëveshjen. Prej përfundimit të zgjedhjeve të 6 tetorit, Lëvizja Vetëvendosje dhe Lidhja Demokratike e Kosovës kishin shprehur vullnetin, që të ishin partnerë në koalicionin e

ardhshëm qeverisës. Mirëpo çështja e ndarjes së posteve kishte bllokuar këto negociata. Zgjedhja e deputetit të LV-së, Glauk Konjufca, në postin e kryetarit të Kuvendit në seancën konstituive, pa pëlqimin e LDK-së, kishte vështirësuar edhe më shumë këto negociata.

Shqipëria përshëndet marrëveshjen LV - LDK

Përfaqësuesit më të lartë politikë të Shqipërisë kanë përshëndetur arritjen e marrëveshjes për bashkëqeverisje LV - LDK. Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka thënë se një qeveri e qëndrueshme është në interes jo vetëm të Kosovës, por edhe të gjithë rajonit. "Përshëndes

këqeverisje

votohet sot



Mësohen emrat e ministrave të LDK-së

Pas mbledhjes së Këshillit të Përgjithshëm të LDK-së është mbajtur edhe mbledhja e kryesisë së kësaj partie, e cila ka propozuar ish-kandidaten për kryeministre, Vjosa Osmani, për kryetare të Kuvendit dhe emrat e tjerë për ministra.

Sipas vendimit të kryesisë së LDK-së, nënkryetari i LDK-së, kryetari aktual i Podujevës, Agim Veliu, është propozuar për ministër të Punëve të Brendshme, Avdullah Hoti është propozuar për zëvendëskryeministër, Lumir Abdixhiku për ministër të Infrastrukturës, Besian Mustafa për ministër të Bujqësisë, Hykmete Bajrami për ministre të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Vlora Dumoshi për ministre të Kulturës, Rinisë e Sportit, si dhe Anton Quni do ta udhëheqë Ministrinë e Mbrojtjes.

Më herët, lideri i LV-së, Albin Kurti, përmes një videomesazhi kishte bërë publike propozimet e veta për ministra nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje. Për zëvendëskryeministër të dytë të qeverisë ai kishte propozuar Haki Abazin, për ministre të Drejtësisë Albulena Haxhiun, për ministër të Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Blerim Rekën, për ministër të Financave dhe Transfereve, Besnik Bislimin, për ministër të Ekonomisë, Tregtisë dhe Industrisë, Rozeta Hajdarin, dhe për ministër të Shëndetësisë, Arben Vitinë. Por, këto propozime mund të ndryshojnë sepse Kurti ka bërë me dije se Glauk Konjufca pas dorëheqjes do të jetë pjesë e ekzekutivit, por pa përmendur se në cilin sektor. Është raportuar se Konjufca mund ta drejtojë MPJ-në.

midis LV-së dhe LDKsë të arritur nga z. Kurti dhe z. Mustafa. Uroj ditë të mbarë nesër në Kuvendin e Kosovës dhe zgjedhje të qeverisë së re të dalë nga rezultati i zgjedhjeve të fundit parlamentare dhe vullneti i qytetarëve! Zgjedhja e institucioneve të Kosovës ka rëndësi të madhe për gjithë rajonin tonë dhe bashkëpunimi ynë nuk do të mungojë”, ka shkruar Ahmeti në llogarinë e vet në

“Facebook”.

Edhe lideri i AKR-së, Behgjet Pacolli, ka uruar për arritjen e marrëveshjes në mes të LV-së dhe LDK-së. “Përgëzoi LV-në dhe LDK-në për punën e tyre të palodhur derisa arrihen konsensus për ta qeverisur Kosovën së bashku për mandatin e tyre të ardhshëm. Kosovën e presin shumë punë dhe sfida. Urime e punë të mbarë!”, ka shkruar Pacolli në llogarinë e vet në “Facebook”.

ngrohtësisht arritjen e marrëveshjes për bashkëqeverisje të Lëvizjes Vetëvendosje (LV) dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) si dy parti fituese të zgjedhjeve të përgjithshme të 6 tetorit 2019 në Kosovë. Një qeverisje e qëndrueshme është në interes jo vetëm të Kosovës, por edhe të gjithë rajonit. Qeverisë së Kosovës të drejtuar nga z. Albin Kurti i uroj suksese dhe arritje sa më të mëdha në të mirë të Kosovës në sfidat që e presin”, ka shkruar Meta në llogarinë e vet në “Facebook”.

Edhe kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, u ka dëshiruar suksese këtyre dy partive në qeverisjen e Kosovës. “Suksese LV - LDK në formimin e qeverisë së re dhe në qeverisjen e Kosovës! Uroj të kemi një

bashkëpunim sa më të dobishëm për shqiptarët këtej e andej kufirit dhe pres me padurim ta shtrojmë në tryezë çështjen e lëvizjes së lirë të qytetarëve e të sipërmarrjeve në kufirin tonë”, ka shkruar Rama në llogarinë e vet në “Twitter”.

Ndërsa lideri i Bashkimit Demokratik për Integritet (BDI), Ali Ahmeti, e ka quajtur lajm të mirë arritjen e marrëveshjes në mes të Lëvizjes Vetëvendosje dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK). Ai ka thënë se zgjedhja e institucioneve të Kosovës ka rëndësi të madhe për gjithë rajonin, duke shtuar se bashkëpunimi i BDI-së me qeverinë e re të Kosovës nuk do të mungojë. “Lajme të mira nga Prishtina për arritjen e marrëveshjes për koalicionin

Kurti ende nuk ka marrëveshje me minoritetet

Pas nënshkrimit të marrëveshjes për bashkëqeverisje me LDK-në, i nominuari për kryeministër, Albin Kurti, ka takuar përfaqësuesit e komuniteteve joserbe, por nuk kanë arritur ndonjë marrëveshje. Ata i kanë kërkuar Kurtit dy ministri për ta mbështetur atë për kryeministër në seancën e së hënës. Pas takimit, deputeti nga grupi parlamentar “6 plus”, Fikrim Damka, ka thënë se gjatë këtij takimi kanë parashtruar kërkesat e veta, ku shpreson

që deri të hënën të realizohen. “Sot kemi pasur takim me kryeministrin Albin Kurti. Në takim kemi qenë gjashtë deputetë si grupi multietnik i ‘6 plusit’, i kemi diskutuar dhe parashtruar kërkesat tona. Unë besoj se Albini me kryesinë e vet do të diskutojë për kërkesat tona dhe do të bëjmë një marrëveshje për koalicionin e ardhshëm. Ne do të diskutojmë për ministrin e dytë”, ka thënë Damka. Edhe kryetari i Listës Serbe, Goran Rakiq, ka deklaruar të

dielën se nuk do ta përkrahin koalicionin LDK-LV. Pas konsultimeve me Qeverinë e Serbisë, ai ka thënë se subjekti i tij politik është ftuar vetëm një herë në konsultime për Qeverinë e re të Kosovës. “Kemi mësuar nga mediat se është arritur njëfarë koalicioni dhe kemi vendosur të mos e përkrahim atë qeveri ngaqë i besojmë vetëm Beogradit”, ka thënë Rakiq pas takimit me kryeministrin serbe Ana Bërnabiq dhe shefin e zyrës për Kosovën në qeverinë serbe, Marko Gjuriq.

Lideri i BDI-së uron botuesin Mavraj për 20-vjetorin e 'Epokës së re'

PRISHTINË, 2 SHKURT (ER) - Kryetari i Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), Ali Ahmeti, ka uruar botuesin Muhamet Mavraj për 20-vjetorin e themelimit të gazetës "Epoka e re".

Lideri i BDI-së, në letërën dërguar Mavrajt, ka thënë se "Epoka e re" ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm në funksion të informimit të drejtë, të saktë dhe cilësor të qytetarëve. "Kam ndrin që t'ju uroj përzemërsisht me rastin e 20-vjetorit të themelimit të gazetës suaj që lindi bashkë me shtetin e Republikës së Kosovës dhe vendosi standarde mediatike jo vetëm në Kosovë, por edhe në Maqedoni dhe Shqipëri, pa përjashtuar edhe diasporën shqiptare", ka shkruar Ahmeti në letërën e urimit dërguar Mavrajt.

Ahmeti më tutje ka theksuar se mediat kanë po aq përgjegjësi edhe sa partitë politike dhe për atë arsye duhet që të angazhohemi bashkërisht drejt avancimit të mëtejme të



shoqërisë sonë. "Gazeta juaj e nderuar po e bën këtë me përpikëri, profesionalizëm dhe me dedikim", ka shkruar Ali Ahmeti.

Më tutje, Ahmeti ka shkruar: "Unë dhe të gjithë ne pranë Bashkimit Demokratik për Integrim shprehim uratat tona më të sinqerta bashkë me



vlerësimet më të larta për korrektësinë dhe bashkëpunimin tonë të ndërsjellë në drejtim të informimit të drejtë dhe të

paanshëm të qytetarëve. Kontributi juaj në shtypin shqiptar është i jashtëzakonshëm dhe ju uroj jetëgjatësi në funksion të informimit të drejtë, të saktë dhe cilësor të qytetarëve", ka shkruar lideri i BDI-së, Ali Ahmeti, në letërën e urimit drejtuar botuesit të gazetës "Epoka e re", Muhamet Mavrajt. Ndërsa ky i fundit, përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook", teksa e ka shpërndarë letëruarimin e Ahmetit, ka falënderuar atë për urimin. "Faleminderit për urimet dhe respektin, shok i kohëve të vështira, Ali Ahmeti! Ju dëshirojmë me të mirat juve dhe gjithë vëllezërve shqiptarë në Maqedoni", ka shkruar Mavraj.

Botuesi Mavraj, pas shumë mijëra urimeve që ka marrë për 20-vjetorin e gazetës "Epoka e re" nga qytetarë dhe personalitete të ndryshme në vendin tonë, ka marrë edhe një letër urimi nga presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta.

Në Lumbardh të Deçanit shënohet 30-vjetori i nismës për pajtimin e gjaqeve

Para të pranishmëve të shumtë, kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj, ka thënë se pajtimi që nisi këtu në Lumbardh të Deçanit, nga atdhetarët, 30 vjet më parë, u përfaqëua në të gjithë Kosovën dhe nga të gjitha shtresat ngaqë, sipas tij, shqiptarët sikur e parandien se çasti i të vërtetës po afrohej, e kjo e vërtetë ishte kryengritja e përgjithshme për liri e pavarësi, që u zhvillua nën udhëheqjen e UÇK-së e që e simbolizon komandanti Adem Jashari



EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

DEÇAN, 2 SHKURT - Kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj, ka bërë homazhe dhe ka marrë pjesë të dielën në shënimin e 30-vjetorit të nismës për pajtimin e gjaqeve në Lumbardh të Komunës së Deçanit. Para të pranishmëve të shumtë, kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj, ka thënë se pajtimi që nisi këtu në Lumbardh të Deçanit, nga atdhetarët, 30 vjet më parë, u përfaqëua në të gjithë Kosovën dhe nga të gjitha shtresat ngaqë, sipas tij, shqiptarët sikur e parandien se çasti i të vërtetës po afrohej, e kjo e vërtetë ishte kryengritja e përgjithshme për liri e pavarësi, që u zhvillua nën udhëheqjen e UÇK-së e që e simbolizon komandanti ynë Adem Jashari. "Kjo besëlidhje e menduar nga intelektualë të urtë, prirë nga Anton Çetta, u ndoq nga rinia e Kosovës, nga

të burgosurit politikë, nga shumë veprimtarë për të kulmuar me tubimin më të madh që njihet në historinë e shqiptarëve, te Verrat e Llukës, më 1 maj 1990, aty ku u mblodhën gjysmë milioni njerëz dhe ku për pak orë u pajtuan 66 gjaqe e ngatërresa mes shqiptarëve", ka thënë Haradinaj.

Siç theksoi ai, besëlidhjet shqiptare zakonisht u paraprijnë betejave të ashpra për jetë a vdekje, që nga Kuvendi i Lezhës i marsit 1444, deri te Lidhja e Pejës dhe ajo e Prizrenit, e qershorit 1878, si dëshmi se shqiptarët dinë të bashkohen për ta mbrojtur lirinë dhe dinjitetin e atdheut. "Si dikur komandanti i ushtrisë së Lidhjes, Sylejman Vokshi, që u priu përpjekjeve për liri, profesor Anton Çetta u ngrit e tha: 'Hajdeni burra, po bëjmë diçka për këtë vend', duke i pajtuar rreth 1 800 gjaqe dhe mijëra plagë e ngatërresa", u

shpreh kryeministri në detyrë Haradinaj, duke shtuar se Anton Çetta ishte unifikues urtak, zbulues i shpirtit të popullit dhe autoritet moral. "Ai mbylli plagën më të shëmtuar tonën, gjakmarrjen, dhe i hap shteg paqes shqiptare dhe kthimit në familjen tonë euroatlantike. Pranë profesor Antonit njeriu ndihej se kishte vlerë. Për t'u lidhur rreth idesë së çlirimit duhej të lidhnim një pakt, një pajtim mes shqiptarëve, që profesor Çetta e arriti në mënyrë shembullore",

ka thënë Haradinaj. Ndër të tjera, kryeministri në detyrë, Haradinaj, ka shtuar se Anton Çetta e ka zbrëthyer kodin e fjalës së dhënë, besën, duke i bërë burrat e ashpër t'ia shtrijnë dorën hasmit të deridjeshëm, për t'u bërë vëllezër të armës, në luftën çlirimtare. "Republikën e Kosovës e kanë bërë intelektualët durimtarë dhe kryengritësit bashkë, sepse dy palët ishin idealistë. Dhe sot, shqiptarët, kanë sërish nevojë për idealistë - patriotë ligjorë -

që besën dinë ta kthejnë në kontratë shoqërore e konfliktin në debat demokratik. Të bashkuar duhet ta fitojmë betejën për vendosjen e sundimit të ligjit, pa alternativë", ka thënë Haradinaj. Në fund të fjalës së tij kryeministri në detyrë, Haradinaj, shprehu mirënjohje dhe lavdi ndaj vajzave e djemve dhe të gjithë atyre veprimtarëve të çështjes kombëtare që u bashkuan këtu në Lumbardh e vazhduan në gjithë vendin.

Dialogu Kosovë - Serbi, nën Ilupën e ShBA-së dhe BE-së

Dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, i lehtësuar deri më tash nga Bashkimi Evropian, ka ngecur aq shumë sa që është vështirë e mundshme që nga vetë Bashkimi Evropian ky dialog të ringjallet dhe të fitojë dinamikë, vlerësojnë njohësit e zhvillimeve politike në Kosovë. Sipas tyre, tashmë Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë ndërmarrë veprime që paralajmërojnë përfshirjen e saj të mundshme për rinisjen e dialogut dhe ndërmjetësimin për arritjen e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse që do ta zgjidhte kontestin Kosovë - Serbi

PRISHTINË, 2 SHKURT - Më 23 janar i dërguari i posaçëm i presidentit Donald Trump për dialogun mes Prishtinës dhe Beogradit, ambasadori Richard Grenell, ka vizituar Kosovën dhe ka porositur lidhshimin politik dhe institucional të Kosovës që ta heqë taksën prej 100 përqindësh ndaj mallrave të Serbisë, ndërkaq që Serbia ta ndalë fushatën e çnjohjes së shtetit të Kosovës.

Brenda pak kohësh ambasadori Grenell ka arritur të ndërmjetësojë në nënshkrimin e marrëveshjes ndërmjet autoriteteve të Kosovës dhe të Serbisë për vendosjen e linjës ajrore Prishtinë - Beograd si dhe ka arritur pajtimin në parim të palëve për rivendosjen e linjës hekurudhore midis Prishtinës dhe Beogradit.

Më 30 janar Kosovën e ka vizituar përfaqësuesi i lartë i Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Josep Borrell, i cili ka thënë se Bashkimi Evropian nuk është në garë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në lidhje me lehtësimin e dialogut për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Por, Borrell, më 31 janar, në Beograd, ka thënë se "Bashkimi Evropian duhet të emërojë një përfaqësues të posaçëm, i cili do të jetë shumë i angazhuar" për shkak se ai vetë nuk është i sigurt se do të ketë "kohë të mjaftueshme për t'u angazhuar dhe për ta shtyrë dialogun përpara".

Zbehja e rolit të BE-së në dialogun Kosovë - Serbi

Njohësit e zhvillimeve politike vlerësojnë se zbehja e rolit të Bashkimit Evropian si një lehtësues i dialogut Kosovë - Serbi ka ndodhur për shkak të gabimeve të mëdha dhe noshalancës me vite për të ndërmjetësuar në realizimin e marrëveshjeve që janë arritur në Bruksel. Gjithashtu, siç thonë ata, mospërputhjet e mëdha që ekzistojnë brenda vendeve të Bashkimit Evropian për

dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë", ka thënë Muhaxhiri. Politologu Ramush Tahiri, duke folur për "Radion Evropa e Lirë", vlerëson se jo vetëm praktikata e Bashkimit Evropian në lehtësimin e dialogut Kosovë - Serbi, por edhe politikata e saj integruese, të cilat kanë vënë në pikëpyetje sinjeritetin e saj rreth zgjerimit në drejtim të Ballkanit Perëndimor, kanë shkaktuar humbje besimi në efikasitetin e saj. "Faktikisht (BE-ja) e ka humbur besimin e popujve të Ballkanit në integritet euroatlantike. Koha nuk pret derisa BE-ja të ndërtojë një strategji të re franko-gjermane për Ballkanin në Evropë ose derisa të bëjë një hapje të re të integritimeve. Mbi këtë bazë, unë konsideroj se është plotësisht e drejtë që të mos pritët, por të ndërmjetësohet. Kredibilitetin e ndërmjetësimin e kanë Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe është mirë që po bisedojnë", vlerëson Tahiri.

Ndihma ekonomike e ShBA-së, 'karrem' për marrëveshjen

Investimi i kapitalit dhe ndihma ekonomike për Kosovën dhe Serbinë, në rast se ato arrijnë një marrëveshje për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet tyre, është premtim të cilin e kanë bërë Shtetet e Bashkuara të Amerikës përmes ambasadorit Grenell.

Analisti Artan Muhaxhiri vlerëson se është e pakuptimtë që zhvillimet e mëdha

ekonomike të ndodhin pa zhvillime të mëdha politike. Sipas tij, fillimisht duhet të qartësohet gjendja politike në rajon, në mënyrë që të jetë e mundur që të vijnë investimet e mëdha. Por, siç thotë ai, në opinionin në Kosovë dhe në Serbi premtimi amerikan për zhvillim ekonomik ka jehonë të madhe. Kësisoj, në mënyrë jo të drejtpërdrejtë synohet një lloj presioni ndaj politikanëve në Kosovë dhe në Serbi, që të jenë sa më konstruktiv në etapën përfundimtare të dialogut. "Është një karrem, sepse është një lloj versioni modern i 'Planit Marshall', pra, tani me specifike për Kosovën dhe Serbinë, sepse konsiderohet që premtimet politike mund të mbesin të përcaktuara nëse nuk ka ndonjë bazë më konkrete. Në rastin e Kosovës dhe Serbisë, baza më konkrete mund të jetë premtimi për zhvillimin ekonomik. Është edhe një element tjetër, që edhe qytetarët e Kosovës, por edhe ata të Serbisë, besoj që u besojnë premtimeve publike të amerikanëve për ndihmë", ka vlerësuar Muhaxhiri.

Politologu Ramush Tahiri shpreh mendimin që opsioni më i mirë do të ishte që në dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë për arritjen e një marrëveshjeje përfundimtare që do të zgjidhte kontestin ndërmjet dy vendeve, të ndërmjetësonin edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, por edhe Bashkimi Evropian.

Por, sipas tij, aktualisht, për shkak të zhvillimeve të brendshme, Bashkimi Evropian

e ka të pamundur të jetë ndërmjetësues i besueshëm, të paktën për Kosovën. "Për shkak të mospranimin nga 5 vende (v.j. të BE-së), nuk e ka një qëndrim neutral ndaj kontestit ose për marrëveshjen ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Ndërsa, Shtetet e Bashkuara të Amerikës e kanë shumë të qartë dhe e thonë që pavarësia e Kosovës është proces i pakthyeshëm dhe i padiskutueshëm në tavolinë, në asnjë variant. Shtetet e Bashkuara të Amerikës dëshirojnë që Kosova dhe Serbia të avancojnë. E kanë planin e përjetësimin të këtyre marrëveshjeve, të cilat do të ndihmohen edhe me investimin e kapitalit amerikan ose të kompanive të ndryshme", ka theksuar Tahiri.

Dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë ka nisur në Bruksel që nga viti 2011 për çështje teknike dhe më pas ka vazhduar në nivelin e përfaqësimit të lartë politik, ku janë arritur më shumë se 30 marrëveshje. Një pjesë madhe e këtyre marrëveshjeve ende nuk janë zbatuar ose janë zbatuar pjesërisht.

Më 21 nëntor të vitit 2018 Qeveria e Kosovës ka vendosur taksën prej 100 përqindësh ndaj prodhimeve të Serbisë dhe Bosnjë e Hercegovinës, si reagim ndaj fushatës agresive diplomatike të Serbisë për tërheqjen e njohjeve të Kosovës, si dhe bllokimin e anëtarësimit të kësaj të fundit në organizata ndërkombëtare. Autoritetet e Serbisë kanë refuzuar ta vazhdojnë dialogun pa heqjen e kësaj takse dhe që atëherë ky dialog ka mbetur i bllokuar.



Buxheti për ushtrinë pritet të jetë 13.4 milionë euro

PRISHTINË, 2 SHKURT - Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) pritet ta ketë buxhetin e saj 13 milionë e 400 mijë euro, pjesa dërrmuese e këtyre mjeteve financiare do të destinohen për blerjen e armëve dhe municionit. Rritje të buxhetit 100 për qind sikur për FSK-në, do të ketë edhe për Policinë e Kosovës nga 1.3 milion në 2.5 milionë euro. Kjo rritje e buxhetit për vitin 2020 ka për qëllim forcimin e ushtrisë, policisë dhe sovranitetin e vendit tonë. Po në këtë vit, sikur në vendet e rajonit, pritet që Kosova me kodin e ri të Doganës dhe akcizës ta ngritë limitin e lirimeve doganore për mallrat e importuara, nga 20 euro sa është aktualisht në 40 euro.

Ministri në detyrë i Financave, Lulëzim Rafuna, në një intervistë për "KosovaPress", ka thënë se rritja e këtij buxheti është interes publik për vendin dhe për sigurinë e vendit, sipas të cilit, duhet të procedohet tutje dhe të ketë një ujdë mes



partive parlamentare për ta votuar buxhetin. Rafuna thotë se buxheti i vitit

2020 është buxhet më i lartë se i vitit paraprak, 2 miliardë e 467 milionë euro i cili nuk parash

ngritjen e ndonjë tatimi ekzistues apo ndonjë tatimi të ri, teksa shtoi se buxheti rritet

nga zhvillimi i aktiviteteve ekonomike. Madje ky projektbuxhet buxhet nëse arrin të votohet në Kuvendin e Kosovës, pas marrëveshjes ndërmjet dy subjekteve politike, LV-ja dhe LDK-ja, nuk do të pësojë ndryshime të mëdha dhe prioritet do ta ketë zhvillimin ekonomik, arsimin, shëndetësinë dhe fushën e drejtësisë. "Ky buxhet prioritet ka zhvillimin ekonomik të vendit, arsimin shëndetësinë si dhe fushën e sundimit të ligjit. Për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe për Policinë e Kosovës buxheti është rritur në 100 për qind, të pjesa e armatimit dhe municionit. Buxheti për ushtrinë ishte 6 milionë e 700 mijë euro, tani është 13 milionë e 400 mijë, për Policinë e Kosovës ishte 1 milion e 300 mijë ndërsa tani është 2 milionë e 500 mijë. Qëllimi është që ta forcojmë ushtrinë, policinë dhe ta forcojmë sovranitetin e vendit tonë", ka thënë ministri Rafuna.

Patundshmëritë, sektori më tërheqës për diasporën

PRISHTINË, 2 SHKURT - Sektori i patundshmërive vazhdon të jetë më tërheqës për qytetarët e Kosovës të cilët jetojnë në vende të ndryshme të Evropës dhe kontinente të tjera. Kjo vërehet edhe në të dhënat e Bankës Qendrore të Kosovës, gjatë muajve korrik, gusht dhe shtator, kur edhe ka lëvizje më të shpeshta të diasporës drejt Kosovës, vlera e investimeve, posaçërisht në patundshmëri, është më e lartë.

Vlera e përgjithshme e investimeve të huaja për periudhën janar-nëntor të vitit të kaluar ishte 265.3 milionë euro. Prej kësaj vlere vetëm gjatë tre muajve (korrik, gusht, shtator) janë investuar mbi 111 milionë euro, prej të cilave rreth 80 milionë euro në patundshmëri.

Zyrtarët në Agjencinë për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve në Kosovë-KIESA, që funksionon në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, theksojnë se të dhënat tregojnë se dominojnë investimet ku është më tepër e përqendruar diaspora e Kosovës.

Në topdhjetëshen e shteteve që kanë investuar më së shumti në Kosovë janë: Gjermania, Zvicra, Turqia, Britania e Madhe, Austria, Shqipëria, Shtetet e Bashkuara të Amerikës,

Slovenia, Franca dhe Bullgaria. Përfaqësues të komunitetit të biznesit, si dhe ekspertë për çështje ekonomike, thonë se rënia e investimeve të huaja dhe përqendrimi i investimeve të diasporës në patundshmëri është shqetësuese.

Kryetari i Aleancës Kosovare të Biznesit Agim Shahini, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se në një hulumtim të realizuar vitin e kaluar, lidhur me investimet e diasporës, rezultojnë se mbi 76 për qind investimeve të tyre janë në patundshmëri, kurse 10 për qind kanë deklaruar se kanë investuar në Kosovë, por që gjysma e tyre kanë pasur sukses. "Diaspora e sheh Kosovën si jo të përshtatshme për investime dhe të ngarkuar me taksë dhe barriera të ndryshme", ka thënë ai.

Edhe profesori i ekonomisë, Musa Limani, në një bisedë për "Radion Evropa e Lirë" ka theksuar se investimet e diasporës po orientohen në patundshmëri për shkak se institucionet kompetente nuk paraqesin projekte adekuata për investime në sektorë të tjerë, të cilat do të krijonin fitime për investitorët dhe rrjedhimisht edhe hapje të vendeve të reja të punës në Kosovë. "Është e vërtetë se 90 për qind e investimeve nga diaspora shkojnë në patundshmëri, blerje



toke, ndërtim shtëpie, blerje banese e kështu me radhë. Por, nuk është faji i tyre, është faji i qeverisë që nuk përgatit programe për t'i orientuar këto investime në prodhim. Prandaj, mendoj se si faktor kryesor material në zhvillimin ekonomik të Kosovës, duhet t'i llogarisim investimet direkte të huaja, veçmas avancimin e kapitalit të diasporës shqiptare", është shprehur Limani.

Në anën tjetër, Agim Shahini ka pohuar se institucionet e Kosovës duhet ta kenë prioritet përmirësimin e fushës ligjore për

tërheqjen e investime nga jashtë. "Qeveria nuk po krijon politika joshëse për investime, qoftë të diasporës, qoftë të huaja dhe kjo e bën Kosovën jo të përshtatshme për investime. Ne duhet të kthejmë këtë potencial në investime kapitale, në investime që gjenerojnë vende të reja të punës dhe jo si mundësi për të blerë shtëpi dhe banesa", ka deklaruar Shahini.

Në një përgjigjeje me shkrim nga Agjencia për Regjistrimin e Biznesit thuhet se gjatë vitit të kaluar janë regjistruar 713 biznese të huaja. Në pjesën e

parë të vitit 2019 kanë qenë 368 biznese, kurse në pjesën e dytë gjithsej 345 biznese.

Investimet e realizuara së fundmi në Kosovë janë përqendruar më shumë tek energjia e ripërtërishme, miniera, ndërtim, turizëm dhe shërbime financiare. Përveç investimeve direkte, trendi i dërgesave të parave nga diaspora kosovare apo remitencave ka shënuar rritje vitet e fundit. Paratë e mërgimtarëve dërguar në Kosovë për nëntë muajt e vitit të kaluar kanë tejkaluar vlerën prej 700 milionë eurosh.

Apelohet për kujdes ndaj importit të mallrave me origjinë aziatike

Qindra persona kanë vdekur e mijëra të tjerë janë prekur nga virusi "Coronavirus" në Kinë. Ky virus tashmë ka arritur edhe në shtetet evropiane ndërsa, veç njerëzve, virusi mund të transmetohet edhe përmes mallrave. Kosova nuk ka linjë të drejtpërdrejtë ajrore me Kinën, por mallrat që vijnë nga ky shtet janë të shumta. Sekretari gjeneral i Chamber Investment Forum - WB6, Safet Gërxhaliu, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se Kosova duhet të tregohet vigjilente dhe të merren masa ndaj importeve aziatike



EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 2 SHKURT - Ka arritur në 304 numri i viktimave nga virusi i quajtur "Coronavirus" në Kinë. Autoritetet kineze kanë njoftuar të dielën se mbi 14 000 raste janë të prekur nga ky virus, që ka shpërthyer në qytetin Vuhan, në provincën Hubei.

Organizata Botërore e Shëndetësisë ka shpallur emergjencë globale pas përhapjes së këtij virusi. Virusi në fjalë tashmë ka arritur edhe në ShBA, Britani dhe në shtetet evropiane. Përveç njerëzve, virusi mund të transmetohet edhe përmes mallrave.

Sekretari gjeneral i Chamber Investment Forum - WB6, Safet Gërxhaliu, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se Kosova duhet të tregohet vigjilente karshi kësaj sfide. Ai ka pohuar se sikurse vendet e tjera të Bashkimit Evropian, edhe Kosova duhet të jetë çdoherë në gjendje gatishmëri ta parandalojë këtë virus. "Me të vërtetë coronavirusi është duke prekur të gjitha vendet, andej edhe Kosova duhet të jetë vigjilente dhe të merren masa ndaj importeve aziatike. Ju jeni dëshmitar se sa shumë jemi të varur nga importi i vendeve aziatike, prandaj AVUK-u dhe Dogana e Kosovës duhet të jenë

në çdo minutë në gjendje gatishmërie", ka thënë Gërxhaliu.

Zëdhënësi i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës, Lamir Thaçi, ka bërë me dije për gazetën "Epoka e re" se Republika e Kosovës nuk ka importe nga shteti i Kinës, të produkteve ushqimore të cilat potencialisht konsiderohen si lëndë e përmes së cilës mund të bartet virusi, njëkohësisht nuk ka as importe të kafshëve të gjalla. "I vetmi import ka qenë ushqimi për bletë dhe hojet e bletëve të cilat i kemi ndaluar menjëherë për import. Kjo na ndihmon që ne t'i shmangemi rrezikut nga vendi i origjinës së virusit. Po ashtu, ndaj secilit shtet që ndërmerren masat e ndalesës së tregtimit të produkteve ushqimore dhe kafshëve, menjëherë ndalesa do të vlejë edhe për tregtim me vendin tonë", ka thënë Thaçi.

Ai ka thënë se Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë në vazhdimësi është duke monitoruar gjendjen prej fillimit të përhapjes së shpejtë të coronavirusit, i cili ka origjinë në Kinë, por që po përhapet edhe në Evropë. "Ne si autoriteti më i lartë për ushqim dhe veterinar jemi të gatshëm që në çdo kohë, me të gjitha kapacitetet që kemi, të vihemi në dispozicion për të vepruar, për parandalimin e përhapjes së sëmundjes në

vendin tonë. Jemi pjesë e komitetit për sëmundje ngjitëse në vend. Jemi në koordinim të plotë me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik. Të gjitha rekomandimet që dalin nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) dhe Qendra e Kontrollit të Sëmundjeve (CDC) jemi të përgatitur që t'i aplikojmë në pjesën e kompetencave tona. Sikurse të gjitha vendet të cilat inkurajohen të vazhdojnë ta forcojnë gatishmërinë e tyre për emergjencat shëndetësore në përputhje me Rregulloren Ndërkombëtare të Shëndetit (2005). Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë ka përvojë të mjaftueshme dhe jemi të përgatitur për veprim në rastet e shpërthimit të sëmundjeve", ka

thënë Thaçi.

Ai ka shtuar se është caktuar zyrtari përgjegjës për hartimin e planit të veprimit dhe kontigjencës për "2019-nCoV", si dhe Inspektorati Sanitar është në gjendje gatishmërie për zbatimin e Ligjit për sëmundje ngjitëse. "Kemi caktuar zyrtarin përgjegjës për hartimin e planit të veprimit dhe kontigjencës për '2019-nCoV'. Inspektorati Sanitar është në gjendje gatishmërie për zbatimin e Ligjit për sëmundje ngjitëse. Kurdo jemi të gatshëm të ngrehim shtabin e krizës përmes të cilit vendosim masat mbrojtëse në kontroll dhe tregtim të ushqimeve dhe kontroll të tregtimit të kafshëve përmes ndalesave që kërkohen të bëhen si masa të përgjithshme veterinarë. Masat e para të cilat do të urdhërohen nga AUJ janë

në përputhshmëri me masat përgjithshme veterinarë dhe sanitare për parandalimin e përhapjes së sëmundjes. Masat të cilat merren nga vendet e Bashkimit Evropian në të njëjtën kohë do të jenë të aplikueshme edhe në vendin tonë", ka deklaruar Thaçi, duke shtuar se i vetmi import ka qenë ushqimi për bletë dhe hojet e bletëve. Ndërkaq zëdhënësi i Doganës së Kosovës, Adriatik Stavileci, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se Dogana zbaton çdo udhëzim që është nga organet kompetente sa iu përket masave preventive. "Në çdoherë jemi të gatshëm t'i zbatojmë urdhrat që na vijnë nga organet kompetente. Në rast të ndonjë dyshimi presim udhëzime nga AVUK dhe jemi të gatshëm t'i zbatojmë ato", ka deklaruar Stavileci.

Licencohet kompania e parë që merret me turizmin ardhës në Kosovë



PRISHTINË, 2 SHKURT - Kompania Balkan Natural Adventure është certifikuar me ISO 9001 certifikatë e menaxhimit, duke e bërë këtë kompani të parën që ka këtë licencë dhe punon ekskluzivisht me turizëm ardhës në Kosovë. Certifikimi është bërë nga kompania kosovare MAAC me ndihmën e një donacioni nga Bashkimi Evropian që iu ka ndarë Balkan Natural Adventure në kuadër të një thirrjeje të Komisionit Evropian për bizneset kosovare.

Certifikimi me ISO dëshmon përkushtimin e kompanisë për menaxhment të mirë dhe dhënie të shërbimeve të mira për klientët. Në kuadër të aktiviteteve të fundit të kompanisë, Balkan Natural Adventure ka filluar ta paguajë sigurimin shëndetësor për të gjithë stafin që është i punësuar me orar të plotë në kompani. Balkan Natural Adventure është tur operator kosovar që punon ekskluzivisht me turizëm ardhës nga vendet e ndryshme të botës.

Nesër përkujtohen të rënët në masakrën e 3 dhe 4 shkurtit në Mitrovicë

MITROVICË, 2 SHKURT (ER) - Komuna e Mitrovicës ka njoftuar se nesër (e martë) do të mbahet një akademi përkujtimore kushtuar 20-vjetorit të masakrës së 3 dhe 4 shkurtit të

vitet 2000. “Të martën, më datën 04.02.2020, duke filluar nga ora 12:00, do të mbahet akademi përkujtimore në Qendrën e Kulturës ‘Rexhep Mitrovica’, kushtuar 20-vje-

torit të masakrës së 3 dhe 4 shkurtit të vitit 2000. Kjo akademi është organizuar nga Komuna e Mitrovicës në bashkëpunim me Këshillin për Mbrojtjen e të Drejtave

dhe Lirive të Njeriut-Qendra Rajonale në Mitrovicë. Ftohen të gjithë të interesuarit të marrin pjesë në këtë akademi përkujtimore”, ka njoftuar Komuna e Mitrovicës.



Prizreni, pjesë e Panairit të Turizmit në Stamboll të Turqisë

PRIZREN, 2 SHKURT (ER) - Komuna e Prizrenit, me qëllim të prezantimit të ofertave të saj turistike, ka marrë pjesë në Panairin Ndërkombëtar të Turizmit “Emitt 2020” që po organizohet në Stamboll të Turqisë. Panairi në fjalë është vizituar edhe nga kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka dhe drejtore-sha e Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, Sevil Kazaz. Nga Komuna e Prizrenit

në këtë panair janë duke marrë pjesë biznese nga fusha e turizmit, të cilët u janë përgjigjur pozitivisht thirrjes publike të Drejtorisë së Turizmit. Nëpërmjet këtij panairi, ku janë duke marrë pjesë ekspertë të shumtë nga fusha e turizmit, po synohet që të lidhen bashkëpunime të ndryshme me tur operatorë të huaj, për ta përfshirë Prizrenin në ofertat e tyre turistike.



Ismajli: Halil Kqiku nuk ishte vetëm i Gjilanit e Anamoravës, por i krejt Kosovës



GJILAN, 2 SHKURT (ER) - Komuna e Gjilanit ka organizuar të dielën një mbledhje komemorative në nderim të veprës së veprimtarit të çështjes kombëtare, Halil Kqiku, e cila është mbajtur nën përkujdesjen e kryetarit Lutfi Haziri.

Gjatë adresimit para të pranishmëve, nënkryetari i Gjilanit, Arbër Ismajli, ka thënë se veprimtari Kqiku nuk ishte vetëm i Gjilanit dhe Anamoravës, por i krejt Kosovës. “Me veprimtarinë e tij të jashtëzakonshme në shërbim të atdheut, ai do të mbetet

përgjithmonë në mendjet dhe zemrat tona. Familja Kqiku duhet të jetë krenare që e pati një atdhetar të madh në gjirin e saj, i cili dha shumë për këtë që po e gëzojmë sot. Lavdi e përjetshme jetës dhe veprës së tij!”, ka thanë Ismajli. Për veprën e Halil Kqikut ka folur

edhe veprimtari Hysen Kqiku, i cili ka dhënë vlerësime të larta për të. Ndërsa ish-komandanti i Zonës Operative të Karadakut, Ahmet Isufi, ka thënë se në çdo ngjarje që ka ndodhur për lirinë e Kosovës, Halili i është përgjigjur pa hez-

itim. Në anën tjetër, vajza e Halil Kqikut, Rina, ka falënderuar Komunën e Gjilanit dhe të gjithë të pranishmit për nderimet që ia kanë bërë babait të saj. Halil Kqiku është varrosur të dielën në varrezat e qytetit të Gjilanit.

Nënshkruhet marrëveshja për renovimin e shkollës “Rexhep Mala” në Topanicë

Kamenicë, 2 shkurt (ER) - Komuna e Kamenicës ka nënshkruar marrëveshjen për renovimin e Shkollës Filllore “Rexhep Mala” në Topanicë të kësaj komune. Renovimi i

shkollës “Rexhep Mala” do të bëhet në kuadër të programit të efikasitet nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik. I lumtur për arritjen e kësaj marrëveshje është shprehur kryetari i

Kamenicës, Qëndron Kastrati, duke treguar se projektet e tilla do të vazhdojnë edhe më tutje. “Është nënshkruar marrëveshja për renovimin e shkollës ‘Rexhep Mala’ në Topanicë, nga

programi i efikasitet nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik. Me vepra, jo propagandë, do të zhvillojmë arsimin në komunën tonë”, ka deklaruar Kastrati.



Fizika dhe kimia simetrike, udhëtim drejt universit (16)

Sferat e fushave vepruese tek elektronet




Shkruan: Naim KRASNIQI, fizikan

Fusha antielektrostatike simetrike e protonit (+fae p) buron jashtë poleve të tornados elektrostatike dhe ka kah të kundërt me fushat elektrostatike simetrike primare (+fep p) dhe fushën elektrostatike sekondare (+fes p) të protonit si dhe buron në formë të valëve shpërndarëse nga qendra në drejtim të periferisë (qendra periferisë), në këtë mënyrë kjo fushë i kundërvihet fushës tërheqëse të ciklonit (ftc) dhe tornados (ftt) të protonit, të cilat fenomene formojnë fusha tërheqëse nga periferia në drejtim të qendrës (periferi qendër). Por, njëkohësisht, fusha antielektrostatike simetrike e protonit (+ fae p) ka vlerë negative (+) x (-) = (-) ashtu sikur fusha elektrostatike simetrike e elektronit (- fes e). Në këtë mënyrë fusha antielektrostatike simetrike shndërrohet në forcë shtytëse me fushën elektrostatike simetrike të elektronit (- fes e). Për të mos i ripërsëritur gjërat në të njëjtën mënyrë sikur te protonet ashtu edhe tek elektronet të cilat nën ndikimin e tornados elektrostatike ndryshojnë nivelin energjetik të kuarkeve (-2/3 d), (-2/3d) dhe (1/3 u), dhe shndërrohen në vetërigjenerator të mikrokuarkeve (-2/3 d)', (-2/3d)' dhe (1/3 u)'. Kurse një vetërigjenerim i natyrës së njëjtë ndodhë edhe tek elementet (aX), (aY) dhe (aZ) te tornadoja dhe cikloni i elektronit. Prandaj, nëse edhe këtu bazohemi në fenomenet natyrore te trupat qiellorë, sidomos te rrotullimi i izoluar i tokës rreth diellit. Ashtu

sikur toka që posedon një fushë magnetike, ajo rrotullohet rreth diellit që, po ashtu, ka një fushë magnetike. Prandaj, tërësisht ngjashëm edhe elektroni ka një ngarkesë elektrike negative ashtu sikur ka edhe protoni, si dhe ngjashëm elektroni me këtë ngarkesë elektrike rrotullohet rreth protonit, ashtu sikur rrotullohet toka rreth diellit. Por duke e pasur si argument se edhe rreth tokës rrotullohet hëna si një satelit natyral, që ka një rreze prej 402 herë më të vogël sesa rrezja e diellit, atëherë nëse hëna shikohet nga një trup qiellor shumë larg nesh as që vërehet në raport me madhësinë e diellit por, gjithashtu, hëna nuk ka një fushë magnetike. Prandaj, edhe pse ne nuk u vërejmë rreth elektroneve gjithsesi rrotullohen edhe grimca të tjera neutrale apo të pangarkuara, ashtu sikur hëna rrotullohet rreth tokës, prandaj, tërësisht ngjashëm edhe elektronet ashtu sikur protonet posedojnë nga pesë sfera në të cilat veprojnë fusha të ndryshme ashtu sikur te protonet. Shiko figurën 28.

1. Sfera e parë e fushës elektrostatike simetrike sekondare (-nfes e), 2. Sfera e dytë e fushës elektrostatike simetrike primare (- fep e), 3. Sfera e tretë e fushës antielektrostatike simetrike (+ fae e), 4. Sfera e katërt e fushës tërheqëse e ciklonit (ftc), dhe 5. Sfera e pestë e fushës tërheqëse e tornados elektromagnetike (ftt).

Fusha antielektrostatike simetrike e elektronit (+fae e) gjithashtu buron jashtë poleve të tornados elektromagnetike, dhe ka kahje të kundërt me fushën elektrostatike primare simetrike (+fep e) dhe fushën elektrostatike sekondare simetrike (+fes e) të elektronit, kurse buron ngjashëm sikur te protoni në formë të valëve shpërndarëse nga qendra në drejtim të periferisë (qendra periferisë), në këtë mënyrë kjo fushë i kundërvihet fushës tërheqëse të ciklonit (ftc) dhe tornados (ftt) të elektronit, të



R5	(aX+aY)
R4	(aX+aZ)
R3	(-2/3 d)', (-2/3 d)' (1/3 u)'
R2	(-2/3 d)', (-2/3 d)' (1/3 u)'
R1	(-2/3 d)', (-2/3 d)' (1/3 u)'

Fig 28

cilat fenomene formojnë fusha tërheqëse nga periferia në drejtim të qendrës (periferi qendër). Por njëkohësisht fusha antielektrostatike simetrike e elektronit (+ fae p) ka vlerë pozitive (-) x (-) = (+) ashtu sikur fusha elektrostatike simetrike e protonit (+ fes e), e cila fushë antielektrostatike simetrike shndërrohet në forcë shtytëse me fushën elektrostatike të protonit (+ fes p).

Sferat e fushave vepruese te neutronet

Neutronet edhe pse konsiderohen si grimca neutrale, prapë se prapë formojnë sferat e veprimit të fushave të tyre. Ashtu sikur e kam paraqitur në botimin 9 të 24 janarit, ku thuhet se në brendi të neutronit ndodhet një anticiklon që e mban stabil bërthamën e atomit, prapë se prapë ne asnjëherë nuk e kemi parë se çfarë forme gjeometrike ka neutroni. Nëse forma gjeometrike e neutronit ndryshon nga ajo e protonit dhe elektronit, atëherë mund të themi se në brendësi të neutronit vepron anticikloni. Por nëse forma gjeometrike e neutronit është e ngjashme me të protonit dhe elektronit, mund të them se në brendi të neutronit nuk ndodhen dy kuarke që e sjellin neutralitetin e neutronit, por ndodhet vetëm një kuarke negativ (-2/3 u) të cilit i kundërvihet fusha antielektrostatike e protonit, e cila forcë e mban distancën në mes protonit dhe neutronit i cili do të qartësohet në të ardhmen përmes paradigmes së fizikës


simetrike. Në këtë mënyrë protoni posedon tri sfera të fushave të veprimit ashtu sikur shihet në figurën 29. 1. Sfera e parë e fushës tërheqëse e ciklonit (ftc), 2. Sfera e dytë e fushës tërheqëse e tornados elektromagnetike (ftt) si dhe 3. Sfera e tretë e fushës së anticiklonit që sqarohet në të ardhmen në paradigmen e fizikës simetrike.

Anomalit e strukturës së brendshme të atomit

Edhe pse shkenca protonet i njej si ngarkesa elektrike pozitive, elektronet si ngarkesa elektrike negative dhe neutronet si grimca neutrale, prapë se prapë deri sot shkenca nuk ka mundur të bëjë një paraqitje të saktë dhe të qartë përmes një fotografie, apo një incizimi të vërtetë gjendjen e ngarkesave elektrike dhe pozitën e saktë të tyre në brendësi të atomit kur ai ndodhet në një gjendje të lirë. Por shkenca sot përmes teleskopëve modern ka mundur ta njohë, përkatësisht fotografoi, incizoi dhe sqaroi formën dhe lëvizjen e saktë të trupave qiellorë qoftë brenda sistemit tonë diellorë, galaksie apo një mini-universi. Për dallim nga makrobota në këtë rast te mikrobota struktura e brendshme e atomit, në pamundësinë e sqarimit vizual të këtyre ngarkesave brenda atomit, e sjellë në një gjendje konfuze dhe të paqartë strukturën e brendshme të atomit. Këtë konfuzitet edhe më shumë e rritë mos ngjashmëria e fenomeneve që ndodhin në mikrobotë dhe makrobotë, të cilat fizikën e kanë ndarë në dy fizika ashtu sikur e ka pranuar edhe vetë Ajnshtajni. Për ta kuptuar më lehtë ndryshimin në mes fenomeneve të mikrobotës dhe makrobotës, nisemi nga fenomenet që ndodhin në makrobotën përkatësisht në sistemin diellorë. Dihet në mënyrë shkencore se rreth diellit rrotullohen trupa qiellorë që nuk posedojnë fushë magnetike

merkuri, venera dhe marsi që e ka humbur fushën magnetike, si dhe trupa qiellorë që posedojnë fushë magnetike toka, jupiteri, saturni, urani dhe neptuni. Kurse rreth këtyre trupave të fundit që posedojnë fushë magnetike rrotullohen satelitë natyral që kanë një formë të rregullt gjeometrike, përkatësisht sferike ashtu sikur e trupave të tjerë qiellorë, por që nuk posedojnë një fushë magnetike.

Prandaj, dielli rreth të cilit rrotullohen të gjithë trupat qiellorë sikur trupat që posedojnë fushë magnetike, ashtu edhe trupat që nuk posedojnë fusha magnetike ka formën e një atomi. Brenda një atomi përkatësisht në qendër të atomit ka protone të ngarkuara me ngarkesë pozitive, dhe neutrone të pa ngarkuara, kurse rreth tyre rrotullohen elektrone të ngarkuara me elektricitet negativ. Po të bëhet një krahasim në mes makrobotës dhe mikrobotës protonet që kanë një ngarkesë elektrike dhe kanë masë më të madhe ndodhen në qendër, ashtu sikur dielli që posedon një fushë magnetike dhe ka masën më të madhe në sistemin tonë diellorë. Nutronet që nuk janë të ngarkuara ndodhën më afër protoneve, ngjashëm sikur venera dhe merkuri që nuk kanë fushë magnetike ndodhen më afër diellit. Kurse elektronet që janë të ngarkuara me elektricitet negativ rrotullohen rreth protoneve dhe neutroneve, ngjashëm sikur toka, jupiteri, saturni, urani dhe neptuni që posedojnë fusha magnetike dhe rrotullohen rreth diellit, si dhe venera dhe merkuri që nuk posedojnë fushë magnetike gjithashtu rrotullohen rreth diellit. Fenomene të tilla të ngjashme shohim thuajse në secilën galaksi, sepse edhe vetë brenda galaksisë ndodhin thuajse të njëjtat fenomene. Një analizë e thjeshtë tregon një ngjashmëri në mes këtyre fenomeneve, por një analizë e detajuar tregon qartë se ndryshojnë tërësisht fenomenet te trupat qiellorë dhe struktura e brendshme e atomit ashtu sikur e njeh fizika. (VIJON)



R1	(aX+aY)
R2	(aX+aZ)
R3	(-aX)n+(-aY)n ?

Fig 29

Terroristi masakron me thikë qytetarët në Londër, ekzekutohet nga policia

LONDËR, 2 SHKURT - Një sulm terrorist ka ndodhur në Londër, ku një person i armatosur me një thikë të madhe ka qëlluar disa persona duke i lënë të plagosur. Menjëherë është njoftuar policia, të cilët pas rezistencës së bërë nga agresori, kanë qëlluar mbi të duke e lënë të vdekur. Sipas autoriteteve angleze burri i vranë kishte si synim që të vriste njerëz me thikë që

mbante në dorë. Ndërkohë mediet angleze kanë publikuar edhe pamjet gjatë aksionit të policisë për të neutralizuar personin që kreu krimin. "Një burrë është qëlluar nga oficerët e armatosur në Streatham. Në këtë fazë besohet se një numër i njerëzve janë qëlluar me thikë. Rrethanat janë duke u vlerësuar dhe ne do të ofrojmë informacione të

mëtejshme sa më shpejt të jetë e mundur. Incidenti është deklaruar si i lidhur me terrorizmin", thuhet në komunikatën e policisë në Londër. Agresori poshtë xhakëtës mbante një jelek të rremë sikur kishte eksploziv të ngjashëm me ato që përdoren në sulmet kamikaze. Por pas kontroleve ka rezultuar se jeleku ishte i rremë.




Gjyqi ndaj Trumpit, Senati kundër thirrjes së dëshmitarëve

Sot (e hënë) do të mbahen argumentet përmbyllëse të gjyqit në Senat, që do të pasohen nga një votim të mërkurën, gjatë të cilit presidenti Trump pritet të lirohet nga akuzat për abuzim me detyrën dhe pengim të hetimeve që po kryente Kongresi

WASHINGTON, 2 SHKURT - Senati me shumicë republikane hodhi poshtë të premten një propozim të demokratëve për të thirrur dëshmitarë të rinj në gjyqin që synon shkarkimin e presidentit Donald Trump. Sot (e hënë) do të mbahen argumentet përmbyllëse të gjyqit në Senat, që do të pasohen nga një votim të mërkurën, gjatë të cilit presidenti Trump pritet të lirohet nga akuzat për abuzim me detyrën dhe pengim të hetimeve që po kryente Kongresi, ka njoftuar voa. Demokratët u përpoqën, por dështuan. Ata kërkuar të thërrasin dëshmitarë të rinj, që do të mbështesnin argumentet e tyre lidhur me akuzat e ngritura ndaj presidentit Trump për abuzim me pushtetin dhe pengim të përpjekjeve të Kongresit për t'i hetuar veprimet e tij. "Ajo që ne po u kërkojmë të bëni në emër të popullit amerikan është e thjeshtë. Përdorni fuqinë tuaj të vetme për të zhvilluar një gjyq të drejtë. Merrni dokumentet që ata nuk pranuan t'ia japin Dhomës së Përfaqësuesve. Dëgjoni dëshmitarët që ata nuk

i lejuan të flisnin para Dhomës së Përfaqësuesve, ashtu siç ka bërë ky organ ka bërë deri tani, në secilin gjyq për shkarkimin e një presidenti. Ndhmoni amerikanët ta kuptojnë se ata meritojnë të vërtetën", tha ligjvënësi demokrat Adam Schiff. Kjo shtytje për dëshmitarë të rinj u përshpejtua në fillim të kësaj jave pas disa zbulimeve falë librit të ish-këshilltarit të Sigurisë Kombëtare John Bolton që pretendonte se Trumpi personalisht i kishte thënë atij se ndihma amerikane për Ukrainën ishte e lidhur me hetimet ndaj rivalit politik Joe Biden dhe djalit të tij, Hunter. "John Bolton mund të vërtetojë pjesën tjetër të provave tona dhe të konfirmojë fajësinë e presidentit. Pra sot, senatorë ju bëjmë thirrje që të lejoni këtë dëshmitar dhe dëshmitarët e tjerë kryesorë që kemi identifikuar, që të dëshmojnë në mënyrë që ju të keni të gjithë informacionin në dispozicion për të marrë këtë vendim të rëndësishëm", tha ligjvënësja demokrat Val Demings.



Por avokatët e presidentit argumentuan se ligjvënësit e Dhomës së Përfaqësuesve duhet t'i kishin intervistuar dëshmitarët gjatë hetimeve që kryen dhe jo gjatë gjyqit në Senat. "Kjo nuk është mënyra se si ky organ duhet të lejojë që t'i paraqiten akuzat për shkarkim të presidentit", tha avokati Patrick Philbin. Presidenti Trump i ka mohuar akuzat e Boltonit dhe ia ka dalë të ruajë besnikërinë e senatorëve republikanë, të cilët thonë se pezullimi i ndihmës për Ukrainën ishte i përkohshëm ndaj dhe nuk mund të përbëjë një shkelje që mund të çojë në shkarkimin e

presidentit. "Ata i morën paratë. Nuk ka pasur asnjë hetim të ish-nënpresidentit Biden dhe djalit të tij Hunter. Nuk mendoj se ky lloj veprimi, edhe pse i papërshtatshëm, trondit themelet e një demokracie", tha senatori republikan Lindsay Graham. Senatorët republikanë Mitt Romney dhe Susan Collins u bashkuan me demokratët në përpjekjen për të thirrur dëshmitarë, por mbështetja e tyre nuk ishte mjaftueshme për të miratuar propozimin, që sipas sondazheve mbështetej nga shumica dërrmuese e amerikanëve. "Presidenti mund të ketë fituar betejën, por në ditët në vazhdim, pasi të dalë e

vërteta, do të humbasë luftën", tha senatori demokrat Tom Carper. Senati shtyu për javën tjetër votimin përfundimtar, në të cilin do të vendoset nëse presidenti Trump do të lirohet nga akuzat apo do të shkarkohet nga detyra. Senatorët pritet të mbajnë fjalimet e tyre përfundimtare për këtë çështje sot (e hënë), në të njëjtën ditë kur mbahen zgjedhjet paraprake në Ajova, të parat për emërimin e kandidatëve presidenciale për zgjedhjet e nëntorit. Votimi përfundimtar është caktuar të mbahet të mërkurën, vetëm një ditë pas fjalimit të presidentit Trump në Kongres mbi gjendjen e vendit.

Borrelli pritet ta vizitojë Iranin

TEHERAN, 3 SHKURT - Shefi i diplomacisë evropiane pritet ta vizitojë Teheranin më 3 shkurt, ka njoftuar Ministria e Jashtme e Iranit. Josep Borrell pritet të takohet me ministrin e Jashtëm Mohammad Javad Zarif si dhe zyrtarë të tjerë iranianë. Udhëtimi i Borrellit shihet si përpjekje e fundit e BE-së për ta shpëtuar marrëveshjen bërthamore të 2015-s, mes Teheranit dhe fuqive botërore. Më maj 2018 presidenti Donald Trump vendosi të tërheqë ShBA-

në nga marrëveshja bërthamore me Iranin duke i vendosur sërish sanksione Teheranit. Pesë vendet e mbetura si palë në marrëveshje, Britania, Franca dhe Gjermania, Kina dhe Rusia janë zotuar ta mbajnë atë gjallë. Teherani i ka reduktuar gradualisht angazhimet e tij në kuadër të marrëveshjes. Pas vrasjes nga ShBA-ja të komandantit të lartë iranian Qasem Soleimani në muajin janar, Irani njoftoi se nuk do t'i respektonte më kufijtë e caktuar

mbi numrin e centrifugave mund të përdoren për të pasuruar uranium. Sipas një deklaratë të lëshuar nga Brukseli, Borrelli u takua me Zarifin gjatë një konference në Indi më 16 janar me qëllimin për të nxitur Teheranin që të "ruajë" marrëveshjen bërthamore gjithnjë e më të brishtë. Borrelli i tha Zarifit se marrëveshja ishte "më e rëndësishme se kurrë", duke marrë parasysh tensionet në rritje në Lindjen e Mesme, thuhej në deklaratë.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

- Quality & Sales Award Recipients**
[Listed in alphabetical order]
- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
 - ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
 - ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
 - ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
 - ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
 - ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
 - ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
 - ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
 - ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
 - ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA HALAL FOOD

PASHTETË PULE

gluten free

100% mish pule

cilësi e garantuar

pa konservues

Historia e panjohur e shqiptarëve në Turqinë e viteve 1912-1923


Historia e panjohur e shqiptarëve në Turqi dhe fundi i Perandorisë Osmane, 1912-1923, i studiuesit amerikan Ryan Gingeras, përkthyer nga Virgjil Muçi, Botimet IDK

Flitet shumë për shqiptarët e Turqisë, por, në të vërtetë, për historinë e atyre dhjetëra mijëra syresh që emigruan në Anadoll mes viteve 1912-1923 dimë fare pak: Ç'ndodhi me ta pasi u vendosën në Anadoll? Pse autoritetet turke i shihnin me aq dyshim, duke mos i lejuar të vendoseshin në qytetet kryesore apo në zonat e konsideruara sensitive? Cila ishte qëndresa e tyre ndaj politikës së shpallur "për të shkukur me rrënjë gjuhën dhe zakonet e tyre", që të ktheheshin në qytetarë besnikë turq? Bazuar kryesisht në hulumtimet e kryera në arkivat turq, studiuesi amerikan Ryan Gingeras na sjell një vepër mjaft të rëndësishme për këtë pjesë thuajse të panjohur të historisë. "Narrativa nacionaliste e historisë së Shqipërisë shmang enkas një nënndarje të rëndësishme të popullsisë: ata që thjesht hoqën dorë krejtësisht prej nacionalizmit shqiptar. Ky segment i kombit "imagjinar" shqiptar përfaqësohej në mënyrë të veçantë nga një numër i madh individësh që emigruan jashtë viseve shqipfolëse të Ballkanit Jugor dhe shkuan u vendosën gjetiu". "Ndonëse në dukje nuk përbënin të njëjtin nivel kërcënimi vdekjeprurës për sigurinë e shtetit, si grekët dhe armenët, që në nenin e parë të talimname të vitit 1917 nënvizohej mosbesimi i përgjithshëm që ekzistonte ndaj shqiptarëve mbas krijimit të një shteti të pavarur shqiptar".

Ryan Gingeras, aktualisht profesor në Departamentin e Çështjeve të Sigurisë Kombëtare në Naval Postgraduate School, SHBA, konsiderohet një ndër njohësit më të mirë të historisë së Turqisë, Ballkanit dhe Lindjes së Mesme. Autor i katër librave, ku mund të përmendim "Rënia e Sulltanatit: Lufta e Madhe dhe fundi i Perandorisë Osmane" (2014) dhe "Heroina, krimi i organizuar dhe bërja e Turqisë moderne" (2015). Libri i tij "Brigje të pikëlluara" ka marrë çmimet "Rothschild Book Prize in Nationalism and Ethnic Studies" dhe "British-Kuwait Friendship Society Book Prize". Më poshtë botojmë parathënien e autorit Gingeras:

Në qoftë se gjërat do të thuheshin troç, ky punim doli në dritë falë një akti burracakërie. Ambiciet e mia, të cilat shkonin përtej provimeve, ishin të prirura për kah njëfarë projekti radikal, sfidues. Pothuajse e kisha mbledhur mendjen që disertacionin do ta shkruaja rreth ndonjë cepi të Anadollit gjatë Luftës së Parë Botërore dhe/ ose fillesave të Republikës Turke. Duke rrahur ta kap demin për brirësh, mora për nga Anadollit Lindor. Sakaq, m'u ndërmendën nja dy ide: ndoshta një studim se si qyteti i vogël i Naxçivan-it u bë pjesë e Azerbajxhanit; ca më mirë akoma, rindërtimi i Kars-it si rrjedhojë e krijimit të Republikës Turke. Të dyja tok, thashë me vete, hyjnë në punë që ç'ke me të. Por ja që miq e kolegë me një barrë përvoje në studimet osmane më paralajmëruan e më thanë se, në thelb, nuk po bëja gjë tjetër veçse do t'ia hiqja vetes profesionalisht. Pikësëpari, ishte çështja e burimeve. Ku do t'i gjeja? A ekzistojnë vallë asi dokumentesh? Dhe çka ishte më e rëndësishmja, a do të më lejonin arkivistët turq të shihja dokumentet (një pyetje kjo që pasohej nga histori anekdotike tmerresh rreth studiuesve që u mohojnë hyrja në arkivat shtetërore në Turqi)?

Paskëtaj vinin pasojat politike që duheshin pasur parasysh. Një disertacion që kishte të bënte me kurdët, armenët dhe subjekte të tjera që konsideroheshin tabu në Turqi, veçse do të më hapte telashe. Pavarësisht se çfarë kisha për të nxjerrë nga duart, më thanë, dikujt kishte për t'i mbetur hatri prej punës sime. Dikush tjetër, qoftë ai ndonjë ministër turk, pjesëtar i diasporës armene ose ndonjë studiues osman, kishte për të më ngrënë me gjithë leckën, duke qenë se kisha sfiduar, mbështetur ose shpërfillur një sërë aspektesh të historisë së kohëve të fundit të Anadollit Lindor. Me pak fjalë, këshilla që më dhanë ishte kjo: mos e bëj. Mos e vrit karrierën tënde, pa filluar mirë. Përfundimisht, disertacioni që shkrova u ngrit mbi këtë këshillë. Koha e kaluar në arkiva më shtyu që të fokusohesha mbi Anadollin Perëndimor, si



dhe tërhoqi vëmendjen time mbi rolin e luajtur prej emigrantëve shqiptarë dhe të Kaukazit Verior përgjatë Luftës për Pavarësi në Turqi. Përgjithësisht, kërkimet e bëra për këtë projekt shkuan si në vaj. Skenarët e maktshëm për të cilët isha paralajmëruar, nuk u vërtetuan. Nuk pati ndalime në jetë të jetëve. Nuk mora ndonjë letër gjithë mllef. Kurrëgjë. E megjithatë, nuk them dot me siguri se miqtë dhe kolegët e mi, njerëz që, në thelb, ma do mendja se më donin të mirën, gabonin. Po, arkivistët, studiuesit dhe punonjësit që takova në Stamboll dhe në Ankara ishin përmjend njerëz mjaft të sjellshëm, të gjindshëm dhe ngandonjëherë, ishte një kënaqësi e vërtetë t'i kishe rreth e qark. Mjaft të zija ngoje dhe të shprehja interesin tim lidhur me emigrantët myslimanë në Anadoll dhe kjo gjë përshëndetej me një entuziazëm të çiltër e gjente mbështetje sakaq nga arkivistët, të cilët ndihmuan që hulumtimi im të bëhej i mundur. Sidoqoftë, rrallëherë e preka temën e armenëve dhe të grekëve me punonjësit e arkivave. Duke qenë se nuk përbënte diçka qendrore ku qe fokusuar punimi im, fati paralel i jomyslimanëve në Anadollin Perëndimor gjatë viteve të luftës përbënte një subjekt që e mbaja të fshehtë. Këshillat e dikurshme gjëllinin ende në mendjen time. Kjo

parathënie shërben si një apologji dhe shpjegim i tërthortë për vijueshmëritë dhe mosvijueshmëritë që vihen re midis disertacionit dhe këtij libri. Pyetja se çfarë ndodhi me grekët dhe armenët e Anadollit (por edhe me grupet e tjera të kriminalizuara) përgjatë viteve 1912-1923, vijon të peshojë edhe sot e kësaj dite si një gorillë 500-paundëshe mbyllur në një dhomë. Ngjarjet e kohëve të fundit, siç qe vrasja e Hrant Dinkut, e vërtetojnë këtë gjë. Prapëseprapë, unë jam i mendimit se persekutimit të të krishterëve osmanë nuk mund t'i qasemi të izoluar. Për më tepër, rreth kësaj pike për mua është krejt e qartë se, përgjatë gjithë kësaj kohe, ka një histori më universale për të kallëzuar lidhur me nivelin dhe domethënien e vuajtjeve njerëzore në Anadoll. Siç do të qartësohet në faqet në vijim, modele të ngjashme të të arsyetuarit dhe të të sjellurit nga ana e qeverisë osmane, por edhe nga fuqitë pushtuese të Greqisë e vendeve të tjera, shpunë në zhvendosjen në masë, shfarosjen si të të krishterëve ashtu edhe të myslimanëve. Shkalla në të cilën bashkësi të ndryshme u vikimizuan nga trupat shtetërore që haheshin me njëra-tjetrën, doemos që ndryshon në mënyrë të papërfytyrueshme (në qoftë se do të shtrëngoheshin të bëja një krahasim, atëherë është më se e

qartë se, aty nga viti 1923, armenët dhe grekët së toku zinin një pozitë shumë herë më pak të lakmueshme sesa emigrantët myslimanë). Në qoftë se dikush merr të krahasojë nivelin e vuajtjeve, kjo nuk ka të bëjë me punën tonë. Përkundrazi, ky libër shtron pyetjen dhe merret saktësisht me faktin se përse, vallë, dhe në ç'masë grupe të mëdha njerëzish që jetonin rreth e qark brigjeve jugore të detit Marmara iu nënshtruan një sërë fushatash që synonin t'u bënin keq. Për të ndriçuar më mirë unanimitetin e vuajtjeve të zbuluara në gjirin e bashkësive të ndryshme që jetonin rreth e qark brigjeve jugore të detit Marmara, e vura theksin kryesisht mbi çështjen armene dhe atë greke. Edhe pse nuk kam kurrfarë dyshimi për këtë gjë, unë besoj se këta hapa vijjnë në ndihmë për të ngushtuar hendekun historik midis të krishterëve vendas dhe myslimanëve të ardhur, madje shumë më mirë se orvatja ime e mëparshme. Ndonëse teksti që vijon nuk është këqyrur si një punim krahasues, mund të thuhet se historia e Anadollit përgjatë kësaj periudhe kohore nuk është diçka unike në kuptimin global. Diskriminimi në masë dhe likuidimi i popullsisë vendase është një fenomen që mund ta pikasësh kudo nëpër botë. Terrori shtetëror i kësaj natyre është një dukuri moderne dhe si e tillë, është pjesë përbërëse e logjikës moderne të shtetndërtimit. Duke e vendosur këtë studim brendapërbrenda një rajoni të caktuar, si dhe duke iu qasur një mase të qartë e të përcaktuar njerëzish, unë shkoj e ndër marr disa koncepte të ngjeshura, historike dhe, siç pranohet përgjithësisht, tejet kritike: modernizimi i shtetit, dhuna e organizuar, formimi i identitetit, emigracioni dhe rrjetet e politikës. Duke e kufizuar punimin tim, si nga ana gjeografike ashtu edhe sociale, shpresoj që ta bëja më të manovrueshëm diskutimin e gjithë këtyre fijeve të larmishme historike, ndërsa narrativën sa më të padukshme. Duke hedhur sytë pas mund të them se nuk më vjen keq që shkova dhe ndoqa këshillat e kolegëve të mi të besuar. Tek e fundit, unë e ndiej se më kanë shpënë pas për të shtjelluar objektivat e mi zanafillorë. Gjithsesi, shpresoj se të tjerë njerëz (që e kanë lëkurën më të trashë se timen) kanë për t'u marrë me historitë e Kars-ës dhe të Naxçivan-it, si dhe ngjarje të tjera me peshë për t'u kallëzuar.

/exlibris.al/

KUR HESHTJA NDIHET ME SY

Duke lexuar librin më të ri me poezi të autorit Izri Rexha, "Heshtja flet me sy"



Nga: Ajet SHALA

Vargu poetik i autorit Izri Rexha në librin më të ri "Heshtja flet me sy", në bërthamën e vet ka tri tema kyçe: temën e fëmijëve, temën sociale dhe temën epike. Këto tema janë trajtuar në mënyra të ndryshme, për t'u bashkuar si lulet në një kopsht me shumë llojshmëri ngjyrash. Autori mban vargun real, komunikues, që në të shumtën e rasteve është edhe mesazh këshillëdhënës, për lexuesit e tij të rinj që presin ta kenë në duart e tyre. Poezia e Rexhës është e pasur edhe me figura e metafora, por autori në të shumtën e poezive përdorë edhe rimën apo muzikalitetin e vargut. Veçanërisht tek poezitë për fëmijë, poezia e Izri Rexhës ka emblemën e edukatës, mirësjelljes, atdheut, ku bukur shpesh vërehet se shkruanedhe për vete, për unin, për bunarin e vjetër, shkollën, vendlindjen etj. Autori fuqishëm nxjerr nga xhepat e zemrës, nostalgjinë për atdheun, rrethin shkollor e shoqëror, por pa harruar asnjëherë mesazhin, apo këshillën, për mirësjelljen. Në fakt vargu i autorit në vetëmban edhe një filozofi të lehtë të mendimit pozitiv, për një shoqëri të shëndoshë.

*Heshtja flet me sy
Nëse do të besosh i shoqëruar,
Do të ishte mirë të përkujtosh të frikshmen,
Ndryshe besimi do të mbetet i zbehtë...*

*Të mendosh ndryshimet me të kundërtën
e saj,
dhe të mos anosh kah e keqja,
Por nga e mira, kah jeta, perspektiva...*

Në vargjet e kësaj poezie të konceptuar si një këshillë apo mesazh, drejtuar lexuesit të tij, me fjalën e thjeshtë por të mirë, të ngrohtë, tek poezia e autorit Rexha zhvillohet një betejë e përhershme mes të mirës dhe të keqes, duke dhënë shembuj e variacione të ndryshme poetike në brumin e vargut.

Vlera artistike e poezisë së autorit mbështetet në bukurinë në të cilën përdor gjuhën si motivacion popullor, dmth. vargun e vet e paraqet të thjeshtë, të rrjedhshëm dhe deklarativ.

*Shqiponja fluturon në thellësi qielli,
folenë e ndërton vetë mbi brigje,
mbi ndonjë gurë apo në ndonjë degë lisi,
ku fryn era dhe trezon dielli.*

Në librin e Izri Rexhës "Heshtja flet me sy" ndoshta pak mund të gjejmë vargje përkushtuese, të dashurisë, apo lirika për dashuri, por kjo s'mund të thuhet për lirikën dhe dashurinë prindërore, për babanë dhe nënën. Autori Rexha bën pjesë ndër poetët e rrallë që i bëjnë varg përkushtues babait, pasi që kjo dashuri prindërore është më shpesh e hasur tek poetet që shkruajnë për nënat.

*Nostalgji
Kam dashur të shkruaj kaheerë për etërit,
edhe më shumë të tregoj për babanë,
që u mishëruan me tokën,
aq shumë rrinte i gatshëm për çdo gjë,
u përkulte në çdo mëngjes,
dhe i falej dheut,
pesë herë në ditë përkulej,
në çdo ditë me plisin e tij të bardhë
lutej për ne,*

Tek poezitë me tema sociale, figurat e prindërve tek autori zënë vend të veçantë, sidomos kur përshkruan se si babai mishërohej me tokën dhe i falej dheut, përherë me plisin e bardhë. Në vargun social, pikërisht autori paraqet krenarinë prindërore dhe familjare.

*Nëna mbillte një oborr me lule,
asnjë nga ato nuk i shiste,
kujdesej që asnjë lloj
të mos i mungoj,
ajo nuk ua dinte emrat,
por i njihte me gjethe, me petale,
dhe iu falte fqinjëve,
i u falte të gjitha mikeshave,*

Përpos temave sociale dhe atyre për fëmijë, tek autori gjejmë disa poezi epike ku autori nxjerr nga thellësia e xhepave të zemrës, brumin për vuajtjet e atdheut që ndryshe mund të quhen edhe vargje vaji, por përherë duke i lënë vendin kyç krenarisë, ballëllartë si plis bardhë e shqiptarë. Madjenë vargjet e poezisë vijuese, autori e paraqet trimërinë përmes personazhit të tij, Osman Taka, i cili kërkon edhe para tytave të pushkatimit, ta lozë një valle, si dëshirën e tij të fundit...

*Kur merrte nga lartë
shkëputej po nga toka,
o bobo si e ndalte me maturi këmbën
o bobo si e ndalte me lëvizje dorën,
duke dridhur trupin sikur fitoj loja,
"Se sot po ngazëllem që vdekja do të vij",
shikimi sypetrit drejt qiellit drejtohej,
kuptonin të tjerët vendlindjen
shqiponjën...*

Erërat e forta të stinëve të trazuar shkundin arrat vjeshtake, ku disa prej tyre mund ti thyesh apo hapësh lehtë me dorë, kurse disave duhet futur tehu e briskut, për ti hapur. Pavarësisht mënyrës së hapjes, frutat i kanë bërthamate njëjta. Brenda tyre është një nostalgji, është një mesazh ndjenje e shqetësimi, është dhimbje, krenari. Në peizazhet e pikturuara, në poezinë e Izri Rexhës, mbizotërojnë temat sociale, familjare, mësuesi shkolla, nxënësit, fëmijëria, por autori shkundë edhe

stinët për të nxjerrë një vizion realist të jetës dhe përditshmërisë. Duke përfshirë edhe temat për atdheun, vuajtjet, persekutimet, tmerret barbare, autori shprehet me vargun e tij tek poezia:


Kur blinim pak bukë.

*Ende më sillet në kujtesë,
një përfytyrim,
i djaloshit të uritur, i rrekuem,
që ecte me cope bukë të falur,
me një shpresë për të ardhmen,
dhe nuk e dija se sa e trisht o jetë je,*

*e ne të mendonim pa të nesërmen,
të ikur në vendet e huaja,
se vdekja ishte ardhë e tmerit,
dhe godiste pa mëshirë
aty ku i themi atdhe,
kurse ne vriteshim mizorisht,
me pështymen dhe sharjet e armikut,
pse në shtëpi rrinim,
pse nuk flisnim si sllavët.*

Vargu poetik i autorit Izri Rexha, brumin e nxjerrë nga konkretja, nga përvoja jetësore nëpër të cilën kakaluar, duke e bartur peshën e saj të rëndë mbi supet e veta, prandaj edhe shfaqen fuqishëm me një realizëm deklarativ, këshillues, që dalin të veshura me këmbë poetiko-filozofike, në të shumtën e rasteve duke u dhënë rimë dhe melodi poetike.

Giubiasco.CH- janar, 2020



E jashtëzakonshme

Shoferët që iu bien borive të veturave në Mumbai detyrohen të presin më gjatë në trafik

Qëndrimi i bllokuar në trafik është shumë i bezdisshëm, ndërsa mund të bëhet edhe më i vështirë nëse shoferët nisin t'u bien borive. Kjo është arsyeja pse policia e Mumbait ka ndërmarrë një veprim, që ta mbajë nën kontroll rënien e borive, me instalimin e një sistemi të semaforëve, që



e zgjatë mbajtjen ndezur të dritës së kuqe, ndërsa zhurma në rrugë është mbi 85 decibel.

FOTO E DITES



Fëmijët në Kabul shihen duke lozur në dëborë. /AFP/

E rrallë

Mbi 500 peshkatarë ngecin në një copë të madhe të akullit

Ekipet ruse gjatë një operacioni të kërkim-shpëtimimit kanë arritur t'i shpëtojnë 536 peshkatarë që kishin ngecur në një copë të madhe të akullit, që ishte thyer në afërsi të ishullit Sahalin në lindje të Siberisë. Disa prej peshkatarëve kishin arritur të shkojnë deri në breg, ndërsa 536 të tjerët patën nevojë për ndihmë për ta arritur një



gjë të tillë. Ekipet e caktuara kanë përdorur copa të vogla të akullit si mjete lundrimi deri në breg. E në momentin kur u shpëtuan, copa e madhe e akullit që ishte ndarë kishte arritur në 200 metra larg bregut.

BARSOLETA E DITËS



Mësuesi: Nga vjen rryma?
Nxënësi: Nga majmunët!
Mësuesi: Në cilën libër e ke lexuar këtë?
Nxënësi: Në libër jo por babi, sa herë që ndalet rryma, thotë e ndalën ata majmunët!



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 18:00 Spies in Disguise 3D

I Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min

Rolet: Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka

Regjia: Troy Quane, Nick Bruno




Në ora 18:00 Jumanji; The Next Level 3D

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min
Rolet: Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser'Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.
Regjia: Jake Kasdan



Çdo natë në ora 20:00 STAR WARS; THE RISE OF SKYWALKER 3D

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min
Rolet: Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj.
Regjia: J.J. Abrams




Çdo natë në ora 22:30 THE GRUDGE

Horror/Mister; 1 orë 34 min

Rolet: Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea Duvall and Bill Pullman


Regjia: Takashi Shimizu



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

<p>DASHI Përkushtohuni ndaj një projekti që dëshironi të realizoni me gjithë forcën tuaj. Është koha për t'i arritur qëllimet tuaja.</p>	<p>DEMI Energjia dhe pasioni janë ndërthurur pozitivisht me shpresën për ta goditur objektivin tuaj dhe, mbase, edhe të fitoni një çmim.</p>	<p>BINJAKËT Tani keni mjaft kohë për t'u çlodhur, për të rimenduar dhe për të lexuar një libër të mirë. Merreni shtruar, do të krijohet një mundësi për të hequr një pengesë.</p>	<p>GAFORRJA Ju mund të filloni nisma të reja, me sigurinë se me kalimin e kohës ata do të japin fryte. Një projekt vërtetoi se keni një mik të vërtetë dhe do të merrni shumë kënaqësi në fund.</p>	<p>LUANI Do të keni një ndjenjë intolerance që së pari nuk mund të arrini ta kapni. Mundohuni të pajtoheni me pasqyrën, nëse nuk ju pëlqen imazhi që do të shihni dhe bëhuni më pak intrigant me veten.</p>	<p>VI RGJËR ESHA Intuita juaj do të dëshmojë të jetë e saktë. Në fushën sentimentale, më në fund, do ta rregulloni një marrëdhënie ku ditët e fundit, ka shkaktuar shqetësime dhe disa momente pasigurie.</p>
<p>PESHORJA Plot pritje! Marrëdhënia në çift mund të ketë disa konflikte, por dialogu dhe komunikimi, jo vetëm verbal, do të ketë shumë efekt pozitiv.</p>	<p>AKREPI Të gjithë ata rreth jush shfaqen si armiq! Kushtojni vëmendje mirëqenies suaj duke zgjedhur atë që ju siguron kënaqësi dhe relaksim.</p>	<p>SHIGJETARI Nuk ka asnjë lajm të madh, por një rutinë e heshtur dhe një zell i mirë që dëshmon produktiv në një nivel praktik. Përfitoni nga koha juaj e lirë për t'i kushtuar vëmendje trupit.</p>	<p>BRICJAPI Asnjë re në qiellin tuaj nga pikëpamja sentimentale: partneri juaj do t'ju ndjekë në të gjitha aspektet. Përmirësoni aftësinë tuaj fizike dhe estetike.</p>	<p>UJORI Në punët e caktuara për këtë ditë do të tregoheni intuitiv dhe të mençur, do të arrini suksese dhe do të ndiheni shumë të vlerësuar. Probleme pagjumësie? Trajtojeni veten për një të diel pushuese.</p>	<p>PESHQIT Shijoni këtë ditë të lumtur, plot stimuj të rinj, tërheqës dhe perspektivë të favorshme! Me sfondin e muzikës romantike, mbrëmja do të jetë e këndshme me një bashkëpunëtor dhe do të përjetoni një intimitet të vluar.</p>

Vdes kitaristi i “Gang of Four”



Andy Gill, një prej anëtarëve themelues të grupit muzikor Gang of Four, ka vdekur në moshën 64-vjeçare. Kitaristi ndërroi jetë pas një sëmundjeje të shkurtër që lidhet me frymëmarrjen. “Turneu

i fundit i Andyt në nëntor ishte e vetmja mënyrë me të cilën ai do të tërhiqej, me një Stratocaster rreth qafës, duke bërë titur me reagime dhe duke e shurdhuar rreshtin e parë të të pranishmëve në koncert”.

Meghan Markle merr mbështetje të madhe nga nëna



Kur Meghan Markle u kthye në Kanada në fillim të këtij muaji, pasi Princi Harry mbeti për t'i finalizuar detajet e daljes së tyre nga jeta mbretërore, ajo nuk u kthye në një shtëpi të zbrazët. “Meghan kishte edhe nënën e saj afër, ndërsa Harry mbeti në Angli”,

ka thënë një burim për “People”. Nëna e Meghan, Doria Ragland, ka qëndruar me të bijën, dhëndrin dhe nipin Archie, ndërsa familja e re qëndron në ishullin Vancouver. “Ajo padyshim merr shumë forcë nga nëna e saj”, thotë një mik i Meghanit.



Dua Lipa sjell “Physical”

Këngëtarja e njohur Dua Lipa ka publikuar së fundi këngën e re “Physical”. Lipa këtë projekt të ri e ka shoqëruar edhe

me klip. Lipa është në përgatitje të albumit të saj të cilin pritet ta ndajë me publikun më 3 prill.

Lady Gaga shihet me një burrë misterioz në ballkonin e një hoteli



Lady Gaga po jeton jetën e saj më të mirë në Florida përpara shfaqjes në Super Bowl. Ajo është parë me një burrë misterioz në një ballkon hoteli derisa ishte e veshur me një rrobë të gjatë e herë me banje. 33-vjeçarja që po qën-

dron në këtë qytet për shfaqjen në AT&T TV Super Saturday Night, e cila u realizua më 1 shkurt, gjeti pak kohë për t'u shoqëruar me këtë burrë. Këngëtarja nga Nju Jorku ndërpreu lidhjen e saj me Christian Carinon.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

Doshlaku: Largimi nga Feronikeli, i vështirë

Lulzim Doshlaku është larguar pas shtatë vjetësh nga klubi i zëmrës, Feronikeli. Ai nuk ndien urrejtje për klubin, por ndihet krenar që ka arritur suksese të mëdha me këtë klub. "Me këtë skuadër jam shpallur tri herë kampion, dy herë fitues i Kupës dhe Superkupës së Kosovës", ka thënë Doshlaku, i cili me skuadrën e re, Dukagjinin e Klinës, synon mbijetesën në Superligë

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, SHKURT - Futbollisti Lulzim Doshlaku në afatin kalimtar të janarit është larguar nga Feronikeli pas shtatë vjetësh. I kontaktuar nga redaksia e sportit e gazetës "Epoka e re", futbollisti ikonë i klubit nga Drenasi ka thënë se largimi nga klubi i zëmrës nuk ka qenë aspak i lehtë. Megjithatë, mbrojtësi është krenar me faktin se ka fituar të gjithë trofetë e mundshëm në futbollin e Kosovës me "Niklin" dhe ka marrë pjesë në garat ndërkombëtare. "Jam larguar pas shtatë vjetëve fantastike të kaluara në skuadrën e Feronikelit. Kemi fituar gjitha trofetë e mundshëm në futbollin e Kosovës, gjithashtu vitin e fundit kemi marrë pjesë në garat evropiane. Me këtë skuadër jam shpallur tri herë kampion, dy herë fitues i Kupës dhe Superkupës së Kosovës. Feronikeli është në zëmrën time sepse është klubi i vendlindjes sime dhe kam kaluar momentet më të mira në karrierën time. Vendimi ka qenë jo i lehtë në fillim, mirëpo kam kaluar në formë huazimi te Dukagjini dhe falënderoj klubin që e ka bërë të mundur këtë kalim", ka thënë Doshlaku, i cili ka kontratë me skuadrën e "Nikli" deri më 2021. "Jam shumë i kënaqur me trajtimin e klubit, sepse nuk më ka larguar, mirëpo trajneri i ri nuk ka llogarit në shërbimet e mia dhe të disa shokëve të mi për shkak se ai e ka parë ashtu të arsyeshme dhe nuk ka pasur ndonjë shpjegim për këtë situatë nga ana e trajnerit. Falënderoj pa masë klubin dhe presidentin Naser Ramaj dhe gjithë trajnerët dhe bashkëlojtarët



që kemi kaluar këto vite fantastike. Gjithashtu, e falënderoj edhe ish-kryesinë e klubit që ka qenë më herët, në veçanti drejtorin Artan Berisha", ka deklaruar Doshlaku. Mbrojtësi Doshlaku është shprehur i kënaqur me mikpritjen në skuadrën nga Klina, Dukagjinin. Lidhur me synimet në sezonin pranveror, ai ka thënë se mbijetesë është një mision i vështirë, por jo i pamundur për t'u arritur. "Te Dukagjini më kanë pritur shumë mirë. E falënderoj drejtorin Fabian Veseli dhe gjithë stafin e trajnerëve, në krye me Severin Elezaj. Gjithashtu, mikpritja e bashkëlojtarëve ka qenë shumë e

mirë. Synim kemi mbijetesën, edhe pse është mision i vështirë, por jo i paarritur, dhe plasmanin në Kupën e Kosovës sa më lart që të jetë e mundur. Te Dukagjini do ta jap maksimumin si çdoherë dhe shpresoj të paraqitem mirë dhe t'i arrijmë objektivat e klubit. Kemi një ekip mjaft të mirë dhe kompakt, me lojtarë kualitativë dhe të dëshmuar në Superligën e Kosovës. Është një klub shumë korrekt. Shpresojmë të na shpërblehet puna dhe angazhimi që e kemi bërë prej fillimit të stërvitjeve dhe përgatitjet që i kemi bërë, ku kemi zhvilluar lojërë mjaft të mira, me disa kundërshtarë", ka përfunduar Doshlaku.

SHKURT

'Tigrat e Zi' falënderojnë futbollistët e larguar për kontributin në KF Feronikeli

Tifozët e KF Feronikeli, "Tigrat e Zi", nëpërmjet një postimi në "Facebook" kanë falënderuar yjet që janë larguar në afatin kalimtar të janarit nga "Nikli". Të larguarit janë Kastriot Rexha, Astrit Fazliu, Arber Prekazi, Albutrint Morina, Haxhi Neziraj, Milos Krkotiq dhe Lulzim Doshlaku. "Ne si tifozeri i falënderojmë të gjithë që ishin pjesë e klubit tonë të zëmrës dhe u dëshirojmë suksese në të ardhmen", thuhet në postimin e "Tigrave të Zi".

Drita me fitore përfundon miqësoren e fundit në Turqi

Drita e ka përfunduar ndeshjen e tretë dhe të fundit në kuadër të përgatitjeve në Antalia të Turqisë. Skuadra nga Gjilani e mposhti ekipin Atyrau nga Kazakistani me rezultat minimal 1-0, kurse golin e shënoi Fidan Gërbeshi nga penalltia. Në këtë ndeshje trajneri iu dha hapësirë edhe lojtarëve të ri si Ardit Mustafës që kishte një mundësi të mirë shënimi dhe Olti Mehmetit, gjithashtu u inkuadruan edhe Dorart Ramadani dhe Drilon Islami që bënë një paraqitje tejet të mirë. Xhevdet Shabani, Kastriot Rexha dhe Izair Emini e përcollën takimin nga tribuna pasi trajneri i kishte lënë të lirë.

Liria mposhti Malishevën në miqësore

Liria është treguar skuadër më e mirë në ndeshjen miqësore të zhvilluar ndaj Malishevës, pasi fitoi me rezultat 3-0. Jurgen Gjini pasi doli në pozitë ballore dhe me goditje precize në brendi shënoi për 1-0. Golin e dytë e realizoi nga penalltia Jasmin Muhoviq, 2-0. Ndërsa, golin e fundit e realizoi Endrit Berisha, pas asistimit të Osman Laqit, 3-0. Të dyja këto skuadra bëjnë gara në Ligën e Parë të Kosovës në futboll.

Tahirukaj regjistron paraqitje të mirë kundër Kreuzlingenit

Drenit Tahirukaj ka pasur paraqitje shumë të mirë në fitoren 24:19 të Kreuzlingenit ndaj Fortitudo Gossau, në kategorinë e dytë të Zvicrës. Repreruesi i Kosovës ka shënuar 10 gola për Kreuzlingenin, skuadër që kapiten e ka Valon Dedajn. Tahirukaj ka shënuar pesë penalltitë që i ka ekzekutuar, ndërsa ishte efikas edhe nga loja. Dedaj në këtë ndeshje nuk shënoi. Te Fortitudo Gossau luan Albin Xhafolli që po ashtu nuk realizoi gol në ndeshjen e së shtunës.

Gjyqtarët kalojnë me sukses testet fizike

PRISHTINË, 2 SHKURT - Nga data 30 janar e deri të dielën është mbajtur Seminari me Gjyqtarë të Futbollit nën përkujdesjen e Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK) dhe UEFA-së, ku instruktorë ka ishte Alan Snoddy. Gjatë

këtij seminari para gjyqtarëve janë ligjruar tema të ndryshme siç janë: Loja me dorë, incidentet në zonën e penallisë, bashkëpunimi si dhe tema të tjera të referimit. Në seminar kanë qenë 75 pjesëmarrës të cilët nën

vëzhgimin e anëtarit të Komitetit Ekzekutiv, Xhelal Broja dhe kryetarit të komisionit të gjyqtarëve, Përparim Hasani, i janë nënshtruar testit fizik. Nga 74 pjesëmarrës në testin fizik, të gjithë kanë kaluar testet

dhe vetëm njëri nga ta nuk ka arritur që të kalojë. Komisioni i Gjyqtarëve ka përcjellë gjithë ecurinë e seminarit dhe vlerëson se gjyqtarët janë të gatshëm për fillimin e sezonit pranveror.



Klopp: Liverpooli nuk është i përkryer

LIVERPOOL, 2 SHKURT - Liverpooli vazhdon të thyejë rekorde në sezonin 2019/20 dhe tani udhëheq në krye të Premierligës me shumë pikë dallim me skuadrën e dytë, por trajneri Jurgen Klopp nuk është i mahnitur, sepse thotë se skuadra e tij nuk është e

përkryer, madje nuk është as afër të qenë e tillë. Të kuqtë kanë qenë pothuajse të pagabueshëm deri tani këtë sezon në ligën elitare angleze, duke i fituar 73 nga 75 pikë të mundshme, apo 24 fitore dhe një barazim në 25 ndeshje deri tani. "Ne nuk i shikojmë statis-

tikat. Kjo është e vërteta. Para ndeshjes ajo që unë ndiej është shqetësimi. Jam person shumë optimist, por jo para një ndeshje futbolli sepse e di qysh kohë më parë se çdo gjë mund të ndodhë; topi sillet në drejtime të ndryshme. Për shembull, Southamptoni pati shumë

goditje në portën tonë, por nuk ia kam idenë sesi Alisson po i mbron këto raste", ka thënë Kloppi. "Ne nuk jemi të përkryer, bile nuk jemi as afër të qenët të përkryer. Ama neve nuk na bënë të jemi të përkryer, ne vetëm mundohemi ta bëjmë më të mirën dhe t'i përdorim



afhtësitë tona në mënyrën më të mirë të mundshme", ka deklaruar Kloppi.

Trepça fiton klasiken ndaj Pejës, Bashkimi mposhti Ponte Prizrenin

Prishtinë, 2 shkurt - Trepça ka shënuar fitore shumë të rëndësishme, duke mundur rivalen e vjetër, Pejën, me rezultat 95:79 (16:13, 25:17, 26:17, 28:32), në kuadër të javës së 24-të në Superligën e Kosovës në basketboll. Çereku i parë ishte kryesisht i barabartë dhe përfundoi 16:13 për vendësit. Në periodën e dytë mitrovicasit ishin edhe më bindës, duke e fituar këtë pjesë 25:17 për të shkuar në pushim me rezultat 41:30. Edhe në periudhën e tretë, 'Minatorët' vazhduan me lojë të mirë, duke thelluar edhe më shumë epërsinë, derisa rezultati në semafor pas 30 minutash ishte 67:47. Në 10 minutat e fundit të ndeshjes Peja u mundua të rikthehet, megjithatë, vendësit ruajtën epërsinë e krijuar dhe në fund fitojnë 95:79. Te Trepça u dalluan Alante Fenner me 27 pikë, pesë kërcime e pesë asistime dhe Dj Hanes me 25 pikë, tetë kërcime e pesë asistime, kurse te Peja, 23 pikë i shënoi Dardan Berisha. Trepça tani ka pesë fitore dhe 16 humbje, derisa Peja ka 12 fitore dhe nëntë humbje. Mitrovicasit renditen në vendin e shtatë (26 pikë), kurse pejanët në vendin e gjashtë (33). Bashkimi e ka mundur Ponte Prizrenin në derbin lokal me rezultat 101:92 (15:20, 24:20, 19:27, 28:19, 15:6). Te Bashkimi u dalluan trashja



amerikane Stevie Clarke me 33 pikë, shtatë kërcime e pesë asistime, Terik Bridgeman me 24 pikë e nëntë kërcime dhe Corey Ross me 19 pikë, derisa te Ponte Prizreni më të mirët në fushë ishin Ty Nichols me 30 pikë

e 10 kërcime, Darial Franklin me 24 pikë e pesë kërcime dhe Urim Zenelaj me 11 pikë e 18 kërcime. Bashkimi tani ka 13 fitore e tetë humbje, derisa Ponte Prizreni 13 fitore dhe nëntë humbje.

Peja shkarkon trajnerin

KB Peja ka konfirmuar se ka shkarkuar trajnerin Jeromin Sarin. "KB Peja njofton se pas humbjes së fundit ka diskutuar për situatën aktuale dhe rezultatet e fundit dhe ka vendosur ta ndërpresë bashkëpunimin me trajnerin Jeromin Sarin", thuhet në njoftimin e KB Pejës. Klubi nga Peja thotë se synojnë trofe. "Pas inves-

timeve tona të fundit ekipi ka pretendime për trofe dhe loja në ndeshjet e fundit nuk na ofron atë çfarë klubi po synon. Klubi shumë shpejt do t'ju njoftojë për trajnerin e ri të cilin do ta angazhojë për ta vazhduar rrugën deri në fund të sezonit. Deri atëherë ekipi do të jetë nën urdhrat e Petrit Zeqirit", thuhet në skuadrës pejane.

Lakersat u rikthehen fitoreve

SACRAMENTO, 2 SHKURT - Los Angeles Lakers nuk fitonte prej dy ndeshjesh radhazi në NBA, ndërsa ambienti ishte bërë edhe më i zymtë me ndarjen nga jeta në mënyrë aksidentale të legjendës së skuadrës dhe basketbollit, Kobe Bryant. Megjithatë, skuadra bëri reagimin e duhur në transfertën ndaj Sacramento Kingsit, ku ia doli të triumfojë me rezultatin 113-129 dhe t'i konsolidojë pozitën në krye të renditjes në Konferencën e Perëndimit. Lakersat e nisën vullshëm sfidën dhe arritën të shkëputen me 22 pikë që në fraksionin e parë, ndërsa në pjesën e mbetur të lojës patën detyrë vetëm ta menaxhojnë avantazhin e konsiderueshëm që krijuan. Sfida mes dy skuadrave në krizë rezultatesh këtë sezon në NBA, Cleveland Cavaliers dhe Golden State Warriors, përfundoi me fitoren bindëse të këtyre të fundit,



me shifrat 112-131. Fraksioni i parë ishte i balancuar, ndërsa dy pjesët e tjera folën qartazi në favor të Warriorsit. Veçanërisht special për miqtë ishte fraksioni i tretë të cilin e fituan me shifrat e thella 19-44, ndërsa ndonëse Cavs u zgjua në fund, nuk mundi të bëjë asgjë për ta shmangur humbjen. Portland Trail Blazers vijon ngjitjen në renditje, teksa mori fitoren e katërt radhazi me shifrat 214-104 përballë Utah Jazz, në një sfidë ku protagonist i vërtetë ishte Damian Lillard me plot

51 pikë të shënuara, 2 rikuperime dhe 12 asistime. Në "Moda Center" të Portlandit vendësit vuajtën disi vetëm në fraksionin e parë, të cilin e humbën me një pikë diferencë, ndërsa më pas morën kontrollin e lojës dhe krijuan shkëputjen e nevojshme për të mos rrezikuar asnjëherë fitoren. Nuk zhgënjeu as Boston Celticsi që mposhti me rezultatin 116-105 Philadelphia 76ers në sfidën e zhvilluar në "TD Garden". Vendësit ishin superiorë në 3 nga katër pjesët e lojës, ndërsa 76ers reagan mirë vetëm në fraksionin e dytë, që gjithsesi ishte i pamjaftueshëm për ta shmangur humbjen. Në sfidat e tjera Dallas Mavericksi triumfoi 123-100 ndaj Atlanta Hawksit, Washington Wizardsi mposhti 113-107 Brooklyn Netsin dhe San Antonio Spursi fitoi me shifrat e thella 114-90 përballë Charlotte Hornetsit.

SHKURT

Manaj shënon golin e parë dhe ndëshkohet me karton të kuq

Rey Manaj ka arritur ta shënojë golin e parë me fanellën e skuadrës spanjolle Barcelona. Sulmuesi shqiptar ditë më parë iu bashkua Barcelonës B nga Albacette, ndërsa ka luajtur edhe ndeshjen e dytë me këtë skuadër. Rey Manaj ka arritur ta shënojë golin e parë me fanellën e skuadrës spanjolle Barcelona. Ylli shqiptar u ndëshkua me karton të kuq dhe kështu u detyrua ta lëshojë fushën. Kujtojmë që Manaj gjatë kësaj jave ka stërvitur me ekipin e parë të Barcelonës.

Gjokoviçi, fitues i Australian Openit

Novak Gjokoviçi ka triumfuar në Australian Open, duke e mposhtur në finale Dominic Thiem, raporton "Reuters". Në ndeshjen e zhvilluar në Melbourne Park tenisti serb shënoi fitore me rezultat prej 6-4 4-6 2-6 6-3 6-4. Me këtë fitore Gjokoviçi rimerr vendin e parë në ranglistën botërore. Ky ishte triumfi i tij i tetë në Australian Open, derisa nuk ka humbur asnjë finale në këtë turne.

Juve, 200 milionë euro për Van Dijk

Kampioni i Italisë, Juventus, është duke planifikuar të bëjë një ofertë mahnitëse, në vlerë 200 milionë euro, për mbrojtësin e Liverpoolit, Virgil van Dijk, gjatë afatit kalimtar të verës. Sipas tabloidit britanik "The Sun", Juventus dëshiron ta bëjë yllin e Liverpoolit mbrojtësin më të shtrenjtë në botë për herë të dytë. Pasi e joshi Cristiano Ronaldon nga Real Madridi, Juve synon ta bëjë të njëjtin edhe me holandezin, në përpjekje për ta fituar Ligën e Kampionëve. Sipas tabloidit britanik, 28-vjeçari mund të jetë i hapur për t'u larguar nëse lideri i Premierligës, Liverpooli e fiton titullin këtë sezon, duke ia bashkangjitur suksesin Ligës së Kampionëve, Kupës së Botës për Klube dhe Super Kupës së Evropës. Klubi nga Seria A e fitoi Ligën e Kampionëve për herë të fundit para rreth 25 vjetëve dhe duke e parë suksesin e brendshëm në dekadën e fundit, trofeu evropian është synimi i madh dhe i vetmi që i mungon.

Flick: Titulli? Kujdes, është edhe Dortmundi

Për Hans Flickin dueli për titull do të jetë padyshim ndaj Borussia Dortmundit, edhe pse Leipzig dhe Monchengladbachu janë aty. "Nuk e pashë ndeshjen e tyre, po rezultati flet vetë. Verdhezinjtë do të jenë një kërcënim deri në fund", ka thënë Flick. Më pas tekniku i bavarezëve foli edhe për ndeshjet ndaj Mainzit ku vlerësoi shumë paraqitjen e skuadrës së tij. "Komplimentet shkojnë për djemtë që në fushën e lojës dhanë gjithçka nga minuta e parë deri në fund. Jam i lumtur për rezultatin dhe lojën. Kur të dyja këto janë pozitive, do të thotë që puna që ke bërë gjatë javës ka dhënë frytet e saj". Ndërkohë, numri 1 i bankinës së kampionëve të Gjermanisë nuk harroi t'i thurte elozhe edhe mesfushorit spanjoll, Thiago Alcantara: "Ai është një lojtar shumë i rëndësishëm për skuadrën tonë. Pashë një magji si në kohët e vjetra. Shpresoj që të vazhdojë kështu, pasi tani nis pjesa e vështirë e kampionatit". Në fund, Flick paralajmëroi skuadrën se nuk duhet të mendojë për majin. "Djemtë janë profesionistë dhe e dinë që muajt e ardhshëm do të jenë decisivë për arritjen e objektivave. Kemi kaluar vetëm gjysmën e sezonit dhe kemi edhe një pjesë të dytë, kjo është më e vështira, duke nisur nga ndeshja e radhës që kemi në shtëpi ndaj Leipzigut", ka deklaruar Flick.



Autor: GAZMEND MORINA		AMATOR	KËNGËTARI I FAMSHËM RAMAZZOTTI (shq.)	ENË E THELLË PREJ QELQI PËR TË PIRË UJË (sh.shq.)	AKTORJA SHQIPTARO-KROATE BERISHA	EPOKA E RE	LLOJ PUSHKE E GJATË (shq.)	ZANORE	DUKURI E RE	RROGA VJETORE E PAPËS	KËPUCË PATINAZHI (shq.) NJË LLOJ SHPATE JO SHUMË E MADHE	↓
	PJESË ANËSO-RE QË DEL SI KRAH NGA TRUNGU (shq.)					KËNGËTARJA AMERIKANE CAREY (shqip.) IPSVICH						
	TALLJA QË BËHET NË MËNYRË TË HOLLË E TË MBULUAR							MËRI, ZILI KUTIA QË SHËRBEN PËR TË RUAJTUR E MBARTUR SENDE				
	LËN SYRI (shq.)					FARISHTA						
	AKADEMIKU STAVILECI					POLITIKANI SHEHU MENDJH-OLLË						
	SHUMË I MADH DHE I FUQISHËM							"IGANDE" LËNDË E BARDHË KRISTALORE SHUMË E ËMBËL				
	ZANORE	FUSHËBETEJA	DALJA NË ZGJEDHJE	VENDËS VARGJET KURANORE						AGIM TEJECI ORACLE TECHNOLOGY NETWORK		
	ANIJATA							PJESËTAR I AONËVE MA JEP				KOHË E DUHUR (turq.)
EPOKA E RE	AKTORI ANGLEZ NË FOTO BLOOM	KËNGËTARE E FAMSHME AMERIKANE (shqip.)	VRAPIMI MË I GJATË NË ATLETIKË	SHOUMENI KRASTA	NINULLA	ROK BEND I YNI INDIANA		QË VEPRON ME GJALLËRI; VEPRUES ARË E MBJELLË ME ORIZ				
OTOMANI						PERSON QË KA PSION PËR TË DEHUR ME ETER ZANORE					ARMENIA I SHËMTUAR (krah.)	
KRYEQYTETI I ARABISË SAUDITE						AKUZUES I SOKRATIT DY BASHKË-TINGËLLORE		RRALLË (Lat.) SHKRONJA XVI			BANKA KOM-BËTARE PIKTORJA JONË PRELVUKAJ	
PJESA E SIPËRME E NJERIU, KU PËRFTOHEZ ZËRI						BAR PËR TË DALË JASHTË (shq.) TEFTA TASHKO			SHKRIMTARI SHEHU LLOJ KRO-KODILI			
TOKA E BUKËS				VEPRIMTARI KRIJUESE ARTISTIKE NËNA		ISMET TOTO KËNGËTARJA SHQIPTARO-AMERIKANE KRISTINE		MJESHTËRI QË USHTRON DIKUSH PËR-DITË FIJE E HOLLË PAMBUKU				ISH FUTBOLLI-STI IGLI
GJATË NATËS					"TETOVA" KLUB FUTBOLLI NË ITALI		ELECTRIC LIGHT ORCHESTRA	BANORET E POLONISË XEHETAR				
BASHKËT.		AKTORI EGJIPTIAN SHARIF				FRIKË E MADHE QENGJ I BUTË				FRYMA ZHVILLIM JONORMAL		
OSAKA		SHKURTABIQI QË KA TË BËJË ME DINAMIKËN						ENHANCED GRAPHICS ADAPTER ALESANDRO NESTA			DËSHIRA QË LË NJERIU ME FJALËT E FUNDIT PARA VDEKJES	BASHKËT. DRU PYLLI I LARTË
EPOKA E RE	DANTE ALIGIERI I GJYMTI			FEMRA LUFTËTARE (mit. greke) KUZHINË PRANË XHAMISË					JETËSHKRIM ARTIOLA TOSKA			
SILIC			ZANORE INTENSITET, METËR, OKSIGJEN	TENISTJA KURNIKOVA MËSYMJA		DEGË E MJEKËSISË THESARI (Lat.)						JETA E QETË DHE E LUMTUR (poet.)
SHPIRTI (Lat.)					TRAJNERI SHOSHOLLI EMNAK I EMRIT ALARE			FUTBOLLISTI I ARSENALIT ROSICKY (shq.) KËNGËTARJA KONÇI				
FAJDEXHI						JEVG IDHULL, IDOL			RADIUM, NITROGJEN BASHKËT.			BASHKËT. MINDER I ULËT (krah.)
I PAMOR-ALS-HËM					KRYEQYTETI I FRANCËS (pashq.) MOLDE					ROKERI AMERIKAN KRA-VITZ (shqip.) FINLANDA, ISLANDA		
TITAN			E PASUR ZANORE				RODA BASHKËT.		FIJE PERI QË KALON PËR-MES QIRIRIT E QË NDIZET RAVENA			
I DREMITUR					QYTET SHQIPTAR NË MAL TË ZI					PËREMËR PRONOR		



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)
Univerziteteske Bolničke i Kliničke Sluzbe Kosova (UBKSK)
Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
Kancelarija za kadrove

Në bazë të nenit 13 pika 3 e Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës, nenit 6 pika 5.1, të Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, dhe Njoftimit të datës 28.01.2020, Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së, nxori këtë:

V E N D I M

Për përsëritjen e Konkursit publik,

- I. Konkursi publik nr. 18, datë 10.01.2020, për **Drejtor Ekzekutiv të Spitalit të Përgjithshëm në Mitrovicë**, për shkak të numrit jo të mjaftueshëm të kandidatëve (aplikuesëve), vazhdohet edhe për 15 ditë nga dita e publikimit në njërin nga mjetet e informimit.
- II. Obligohet Sektori i Personelit për zbatimin e këtij Vendimi;
- III. Vendim hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Sektori i Personelit të QKUK-së pas mbylljes së konkursit Publik për Drejtor Ekzekutiv të Spitalit të Përgjithshëm në Mitrovicë më datë 27.01.2020 e Njofton Drejtorin e Përgjithshëm të SHSKUK-së që konkuri është mbyllë por nuk ka pasur kandidatë të mjaftueshëm për pozitën dhe kërkon që konkursi të vazhdohet sipas nenit 6, pika 5.1 e Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, edhe 15 ditë.

Prandaj, Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së, në bazë të kompetencave, konform ligjit në fuqi dhe Kërkesës në fjalë, lejon përsëritjen e Konkursit publik si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Me sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

VENDIMI T'I DORËZOHET

- ✓ Zyrës së personelit,
- ✓ Një mediumit informativ.
- ✓ Arkivit.

Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së

Dr. Basri Sejdiu



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)
Univerziteteske Bolničke i Kliničke Sluzbe Kosova (UBKSK)
Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
Kancelarija za kadrove

Na osnovu člana 13, stav 3 Statuta Sluzbe Bolnice i Kliničke Universiteteske Kosova, član 6 tačka 5.1, Administrativno uputstvo (MRSZ) br. 07/2017 o Regulisanju Procedura Javnog Konkursa i Izveštaj datum 28.01.2020, Generalni Direktor UBKSK je izdao:

O D L U K A

Za ponavljanje javnog Konkursa,

- I. Javni konkurs br. 18, od 10.01.2020, za Izvršnog Direktora Opšte Bolnice u Mitrovici, zbog nedovoljnog broja kandidata (aplikanta), nastavlja se i za 15 dana od dana objavljivanja u jednom od sredstava informisanja.
- II. Sektor za osoblje je obavezan da sprovede ovu Odluku;
- III. Odluka stupa na snagu danom potpisivanja.

O b r a z l o Ź e n j e

Sektor za kadrovske poslove UKCK-a nakon zatvaranja Javnog konkursa za Izvršnog Direktora Opšte Bolnice u Mitrovici, dana 27.01.2020 objavljuje Generalnog Direktora UBKSK-a da je konkurs zatvoren, ali nije imao dovoljno kandidata za objavljena konkursa i traži da se konkurs nastavi prema članu 6, tačka 5.1 Administrativnog uputstva (MRSZ) br. 07/2017 o Regulisanju postupka Javnog Konkursa, još 15 dana.

Prema tome, Generalni Direktor UBKSK, u skladu sa nadležnostima, i sa važećim zakonom i predmetnom Zahteva, dozvoljava ponavljanje javnog konkursa kao u dispozitivu ove odluke.

Kao što je već navedeno, odlučeno je kao u dispozitivu ove odluke.

ODLUKA KOJI SE PODNOSI

- * Kancelarija za kadrove,
- * Informacioni medij,
- * Arhiva.

Generalni Direktor UBKSK.

Dr. Basri Sejdiu

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo Unutrašnjih
Poslova
Ministry of Internal Affairs
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/Prishtinë
Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate



Në pajtim me Ligjin e punës Nr. 03/L-212 kreu II, neni 8, Ligjin për Policinë Nr. 04/L-076, kreu V, Neni 44 i këtij ligji, Udhëzimin Administrativ 02/2018 mbi marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës, Kreu III, Neni 5, paragrafi 2/2, Policia e Kosovës shpall:

KONKURSIN

Referenca: 07/1-01SAP-R/06/20

Për plotësimin e vendit të punës

I. Titulli i vendit të punës: Teknik medicinal (katër vende të lira pune)
Vendi i punës: Një pozitë në Drejtorinë e Shërbimeve Shëndetësore DPP- Prishtinë, një pozitë në Drejtorinë Rajonale Pejë, një pozitë në Drejtorinë Rajonale Mitrovica Jugut dhe një pozitë në Drejtorinë Rajonale Gjakovë.

Koeficienti: H - 59

Kohëzgjatja e emërimit: Në afat të pacaktuar

Kategoria funksionale dhe grada e vendit të punës: Niveli profesional

Orari i punës: i plotë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Përkrahja mjekësore në situata emergjente gjatë planeve operative të PK-së, si dhe shërben si ndërlikohës midis pjesëtarëve të PK-së, shërbimeve shëndetësore të PK-së dhe ofruesve të shërbimeve shëndetësore publike.
- Përgjegjës për përcjelljen e informatave mbi pushimet mjekësore të zyrtarëve mjekësorë si dhe përgjegjës teknik për implementimin e programeve për promovimin e shëndetit.
- Përgjegjës për monitorimin dhe koordinimin e rasteve siç është udhëzuar nga zyrtari mjekësor dhe aprovon/refuzon, kërkesat e pushimit të rregullt mjekësor.
- Përgjegjës për pranimin e dokumentacionit mjekësor të pranuar dhe përcjelljen e informatave pjesëtarëve të PK-së, lidhur me dokumentacionin mjekësor të pranuar (informimet, refuzimet).
- Viziton të sëmurit apo të lënduarit në detyrë, raporton me shkrim tek shefi i sektorit rreth gjendjes shëndetësore të tyre.
- Do t'i përgjigjet thirrjes në planet operative të Njësisë Speciale (në testimet fizike dhe në rastet e gjuajtjes-trajnimin në poligon), operacione të neutralizimit të materieve eksplozive.
- Kryen detyra tjera në fushën profesionale specifike në përputhje me ligjet dhe rregulloret aktuale të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe.

Shkollimi i kërkuar dhe shkathtësitë:

- Të posedojë diplomën e shkollës së mesme për infermier.
- Përvojë pune tri (3) vjeçare në fushën përkatëse (infermier/e e mjekësisë emergjente).
- Të posedojë certifikatë (dëshmi) profesionale për dhënie e ndihmës së parë emergjente.
- Afësi profesionale të punojnë në mënyrë të pavarur.
- Afësi të punojnë në situatë emergjente.
- Afësi të punojnë në ekip të shumëllojshëm.
- Shkathtësi të mira ndërpersonale.
- Të ketë shkathtësi të komunikimit me shkrim dhe me gojë.
- Patentë shofer valid dhe afësi të ngasë veturën.
- Njohuri të programeve të Microsoft Office: Word, Excel, PowerPoint, Outlook, Project etj.

Kandidatët që aplikojnë për pozitat e stafit civil duhet t'i plotësojnë kriteret themelore si në vijim:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të jetë i moshës 18-64 vjeçar;
- Të ketë të përfunduar shkollimin përkatës për pozitën që aplikojnë;
- Të mos jetë i dënues për ndonjë vepër penale;
- T'i plotësojë kriteret shtesë për atë pozitë;
- Të ketë integritet personal dhe vlera të larta etike.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Formulari për aplikim;
- Deklarata (lidhur me pajtueshmërinë e hetimeve të së kaluarës), mund ta shkarkoni në ueb-faqen e Policisë së Kosovës www.kosovopolice.com ku gjendet shpallja e konkursit dhe pas nënshkrimit nga aplikanti i bashkëngjitet aplikacionit;
- Kopja e diplomës për arsimin e kërkuar, ndërsa për kandidatët që kanë përfunduar shkollimin jashtë vendit kopjen e diplomës të notifikuar;
- Dëshmi për kualifikime tjera, dëshmi për përvojën e punës;
- Certifikata /ekstraktin e lindjes;
- Vërtetimi nga gjykata që nuk është i dënues dhe që nuk është nën hetim;
- Kopja e letërnjoftimit ose pasaportës valide;
- Një fotografi të formatit (5 x 5);
- Dokumentet nga pika e dhe f duhet të jenë të vlefshme dhe të nxirren pas datës së shpalljes së konkursit.

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin:

Ligjin për Policinë Nr. 04/L-076, Kreu V, Neni 44 i këtij ligji, Udhëzimin Administrativ 02/2018 mbi marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës, Kreu III, Neni 5 paragrafi 2/2.

Bazuar në aktet ligjore të lartpërmendura të gjitha aplikacionet dhe dokumentacioni i pranuar do të shqyrtohet me kujdes dhe gjatë shqyrtimit nëse konstatohet se kandidati nuk i plotëson kriteret e përcaktuara për aplikim dhe punësim, apo nëse aplikacioni përmban të dhëna të rrejshme kandidati menjëherë do të diskualifikohet. Kandidatët e suksesshëm do të ftohen të marrin pjesë në testimin me shkrim dhe me gojë. Kandidatët që kalojnë testin me shkrim do t'i nënshtrihen testit me gojë (intervistimit).

Këto pozita i nënshtrihen procesit të verifikimit dhe mund të plotësohet vetëm pas përfundimit të suksesshëm të procesit të verifikimit.

Në fund të procesit përzgjedhës kandidatët e pazgjedhur kanë të drejtë në ankesë.

Informimi i kandidatëve lidhur me rezultatet të çdo faze të testimeve do të publikohet në ueb - faqen e Policisë së Kosovës, në adresën: www.kosovopolice.com, te rubrika mundësi e punësimit.

Data e fillimit dhe e mbylljes së konkursit:

Konkursi është i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data e shpalljes së konkursit në të përditshmet kosovare, duke filluar nga data 03.02.2020 deri me 17.02.2020.

Mënyra e aplikimit:

Formularët duhet t'i dorëzohen Sektorit për Rekrutim dhe Seleksionim, Ndërtesa e re e Administratës, DPP, Prishtinë, personalisht ose dërgohen me postë në këtë adresë: **Policia e Kosovës, rr. "Luan Haradinaj", 10000 Prishtinë, Sektori i Rekrutimit dhe Seleksionimit, kati i III, zyra 54**, çdo ditë pune nga ora 09:00-15:00 deri në afatin e fundit për konkurrim. Dokumentet e pranuar nuk do të kthehen!

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vullën postale mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda 4 ditësh.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen. Formularët për aplikim janë në dispozicion në Sektorin e Rekrutimit dhe Seleksionimit, DPP, Prishtinë, apo në ueb-faqen e Policisë së Kosovës www.kosovopolice.com ku gjendet shpallja e konkursit.

Numerat kontaktues: Për informata plotësuese mund të thirrni në numrin e telefonit kontaktues nr.: 038- 5080 lokali: 1002 /038-504504 lokali:1751 dhe 038 245 184.

"Policia e Kosovës i shërben gjithë popullit të Kosovës. Ky shërbim ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe i mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë".



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo Unutrašnjih
Poslova
Ministry of Internal Affairs
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/Prishtinë
Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate



U skladu sa Zakonom Rada Br. 03/L-212 poglavlje II, član 8, Zakona o Policiji Br. 04/L-076, poglavlje V, Član 44 ovog Zakona, Administrativnim Uputstvom 02/2018 o radnom odnosu u Policiji Kosova, Poglavlje III, Član 5, stav 2/2, Policija Kosova objavljuje ovaj:

KONKURS

Referencija: 07/1-01SAP-R/06/20

Za popunjavanje radnog mesta

I. Naslov radnog mesta: Medicinski tehničar (četiri slobodna radna mesta)

Radno mesto: Jedan položaj u Direkciji Zdravstvenih Službi GDP, Priština, jedan položaj u Regionalnoj Direkciji Peć, jedan položaj u Regionalnoj Direkciji Mitrovica Jug i jedan položaj u Regionalnoj Direkciji Djakovica.

Koeficient: H - 59

Trajanje imenovanja : Na neodređeno vreme

Funkcionalna kategorija i rang radnog mesta: Profesionalni nivo

Radno vreme: puno

Zadaci i odgovornosti:

- Lekarska podrška u emergentnim situacijama tokom operativnih planova PK-a, i služi kao veza između pripadnika PK-a, zdravstvenih službi PK-a, i pružiocima javnih zdravstvenih usluga.
- Odgovoran/a za dostavljanje informacija o lekarskim bolovanjima lekarskog službenika i tehnički odgovorni za implementaciju programa za promovisanje zdravlja.
- Odgovoran/a za monitoriranje i koordiniranje slučajeva kao što je upućen od strane lekarskog službenika i usvaja /odbija zahteve za redovna bolovanja.
- Odgovoran/a za prijem dostavljene lekarske dokumentacije i dostavljanje informacija pripadnicima PK-a, u vezi prijema lekarske dokumentacije (obaveštenja, odbijanja).
- Obilazi bolesne ili povredjene na dužnosti, pismeno obaveštava Šefa Sektora, o njihovom zdravstvenom stanju.
- Odazvaće se pozivima za operativne planove Specijalne Jedinice (na fizičkim testiranjima i u slučajevima gadjanja – obuke na poligonu, operacije neutralizovanje eksplozivnih sredstava).
- Obavlja i druge poslove iz profesionalne specifične oblasti u skladu sa važećim zakonima i pravilnicima koje opravdano mogu se zahtevati s vremena na vreme.

Zahtevano obrazovanje i veštine:

- Da poseduje diplomu srednjeg obrazovanja za medicinskog tehničara.
- Radno iskustvo od tri (3) godine, iz odgovarajuće oblasti (med.tehničar emergentne medicine).
- Da poseduje profesionalno uverenje (dokaz) za pružanje prve hitne pomoći.
- Profesionalne sposobnosti za nezavisni rad.
- Sposobnosti za rad pod emergentnim slučajevima.
- Sposobnosti za rad u višersnu ekipu.
- Dobre međusobne veštine.
- Da ima veštine pismenog i usmenog komuniciranja.
- Da ima Validnu vozačku dozvolu i dobre veštine upravljanja vozila.
- Odlično poznavanje rada kompjuterom Microsoft Office: Word, Excel, PowerPoint, Outlook, Project i td.

Kandidati koji apliciraju za položaj civilnog osoblja treba da ispunjavaju sledeće osnovne uslove:

- Da je građanin Republike Kosova;
- Da je 18-64 starosti;
- Da je završio adekvatno obrazovanje za položaj za koji aplicira;
- Da nije kažnjen za neko krivično delo;
- Da ispunjavaju dopunske kriterijume za taj položaj;
- Da ima lični integritet i visoke etičke vrednosti.

Potrebna dokumentacija za apliciranje:

- Obrazac za apliciranje;
- Izjava (u vezi istrage prošlosti), možete preuzimati iz Web stranice Policije Kosova www.kosovopolice.com gde se nalazi objava konkursa i nakon potpisivanja od strane aplikanta, prilaže se aplikaciji;
- Kopiju diplome za traženo obrazovanje, dok za kandidate koji su završili školovanje van zemlje, kopiju nostrifikovane diplome;
- Dokaz o drugim kvalifikacijama, dokaz o radnom iskustvu;
- Izvod/ekstrakt rođenih;
- Potvrdu iz suda da nije kažnjen i da nije pod istragom;
- Kopiju validne lične karte ili pasoša;
- Jednu sliku formata (5 x 5);
- Dokument iz tačke e i f treba da budu validni i da se vade pre datuma objavljivanja konkursa.

Zakonski i podzakonski akti koji regulišu regrutovanje:

Zakon o Policiji Br. 04/L-076, Poglavlje V, Član 44 ovog zakona, Administrativno Uputstvo 02/2018 o radnom odnosu u Policiji Kosova, Poglavlje III, Član 5 stav 2/2.

Na osnovu gore pomenutih zakonskih akata, sve aplikacije i primljena dokumentacija se treba pažljivo razmatrati i tokom razmatranja ukoliko se utvrdi da kandidat ne ispunjava kriterijume određene za apliciranje i zapošljavanje, ili ukoliko aplikacija sadrži lažne podatke, kandidat se odmah diskvalifikuje. Uspešni kandidati će biti pozvani da učestvuju na pismenom i usmenom testu. Kandidati koji polože usmeni test, podvrgnuće se usmenom testiranju (intervjuisanju)

Ovi položaji će se podvrgnuti procesu provere i mogu se popuniti samo nakon uspešnog sprovođenja procesa provere.

Na kraju procesa selekcije, izabrani kandidati imaju pravo žalbe.

Informisanje kandidata u vezi rezultata o svakoj fazi testiranja objaviće se na web stranici Policije Kosova, na adresi: www.kosovopolice.com, kod rubrike mogućnost zapošljavanja.

Datum početka i završetka konkursa:

Konkurs je otvoren petnaest (15) dana od dana objavljivanja konkursa u kosovskim dnevnim novinama, počevši od 03.02.2020 do 17.02.2020.

Način apliciranja:

Obrazci treba da se predaju Sektoru za Rekrutovanje i Selektiranje, Nova Zgrada Administracije, GDP, Priština, lično ili se šalju poštom na adresi: **Policija Kosova, ul. "Luan Haradinaj", 10000 Priština, Sektor Rekrutovanja i Selektiranja, III sprat, kancelarija 54**, svakog radnog dana od 09:00-15:00 do zadnjeg roka za konkurisanje. Primljena dokumenta se ne vraćaju!

Aplikacije poslate poštom koje imaju poštanski pečat na pošiljci koja su poslati zadnjeg dana roka za apliciranje će se smatrati validnim i uzeta u obzir ukoliko stignu u roku od 4 dana.

Zahtevi poslati nakon zadnjeg datuma se neće primati. Nekompletirani zahtevi se mogu odbiti.

Obrasci za apliciranje su na raspolaganju u Sektoru Rekrutovanja i Selektiranja, GDP, Priština, ili na web stranici Policije Kosova www.kosovopolice.com gde se nalazi objavljeno konkurs.

Kontakt brojevi: Za dodatne informacije možete pozvati na kontaktnom telefonskom broju: 038- 5080 lokal: 1002 /038-504504 lokal:1751 i 038 245 184.

"Policija Kosova služi celom narodu Kosova. Ova služba nudi jednake mogućnosti zapošljavanja za sve državljane Republike Kosova i prihvata aplikacije od svih osoba muškog i ženskog roda svih zajednica na Kosovu".



Dje më 03.02.2020 u bënë 5 vite pa më të dashurën tonë

Hatije Morina

Veterane e (ILEGALES) dhe UÇK-ës
1972-2015

U bënë 5 vite nga vdekja e më të dashurës tonë. Askush nga ne nuk mund ta paramendoj mëtej jetën pa ty. Mirëpo ky rrugëtim i jetës tonë është përplot dhembje dhe mall që gjithmonë ishe dhe do mbetesh udhërrëfim për ne.

Të përkujtojm me mall: bashkëshorti Ramizi, si dhe farefisi Morina.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Sherif Bali Kabashi shpall të pavlefshme diplomën e Fakultetit të Edukimit (Shkolla e Lartë Pedagogjike -Gjakovë), me nr. 1959.

► Lulzim Baruti shpall të pavlefshme numrin e biznesit me nr. 70777630 dhe nr. fis. 810558603.

► Bashkim Muli, shpall të pavlefshëm certifikatën e biznesit individual me numër: 71337855, Vushtrri.

► "Lux Dentima", SH.P.K. me numër të biznesit 810190249 me adresë në Prishtinë, Rr, Elbasanit p.n i njofton të gjithë debitorët dhe kreditorë se ka marre vendim për zvogëlimin e kapitalit themelor, zvogëlimi i kapitalit themelor do të bëhet nga shuma fillestare 50000 (pesëdhjetë mijë) në 5000 Euro.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente,

një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkohet një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanë me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet

Kërkohet kujdestare për vajzën 7 muajshe në Prishtinë. Për informata në tel: 044-444-009

prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë.

Shes truallin prej 36 arë në fshatin Besi; 150 metra nga magjistralja Prishtinë-Besianë. Trualli ka gjithë infrastrukturën e nevojshme dhe është shumë i përshtatshëm dhe për banim kolektiv. Po ashtu lëshojmë me qira vendin për restorant me një pamje atraktive dhe piktoreske me në një lartësi të madhe mbidetare.
Tel. 044-413-197.

WE

Women in Energy

Gratë në Energji
Programi i Punës Praktike

Për të gjitha detajet:
[millenniumkosovo.org/
womeninenergy](http://millenniumkosovo.org/womeninenergy)

Thirrje për shprehje të interesit nga institucione dhe organizata të ndryshme në sektorin e energjisë në Kosovë, për angazhim të praktikanteve në punë, paguar nga MFK.

Në kuadër të projektit "Gratë në Energji - Women in Energy", të lansuar nga Fondacioni i Mijëvjeçarit i Kosovës (MFK), së shpejti do të fillojë zbatimi i programit "**Punë praktike për gra në sektorin e energjisë**" i cili ka për synim fuqizimin dhe përfshirjen e gruas në sektorin e energjisë në Kosovë.

Qëllimi i këtij programi është të mbështesë ngritjen e kapaciteteve të nevojshme profesionale të grave duke ju ofruar atyre përvojë përmes punës praktike me pagesë në institucionet publike dhe private të sektorit të energjisë në Kosovë. Paga bazike do të ofrohet nga MFK për kohë të caktuar deri në gjashtë muaj.

Përfituese të këtij programi do të jenë të gjitha gratë dhe vajzat që shprehin interesim për praktikë në punë në sektorin e energjisë e të cilat janë në vitin e fundit të studimeve Bachelor, studentet e nivelit Master, si dhe ato që kanë diplomuar në tri vitet e fundit por që nuk kanë pasur mundësi të punojnë në profesionet e tyre. Profili i vajzave aplikante do të përfshijë jo vetëm ato që i përkasin fushave STEM (Shkencë, Teknologji, Inxhinieri dhe Matematikë), por edhe disiplina të tjera të rëndësishme për sektorin e energjisë, të tilla si menaxhimi i projektit, marketingu dhe financat, ekonomia, legjislacioni, politikë-bërje, teknologjia e informacionit si dhe profile të tjera të nevojshme në këtë sektor.

Andaj, ju bëjmë thirrje të gjitha **institucioneve në sektorin publik dhe privat, organizatave joqeveritare si dhe organizatave ndërkombëtare** të angazhuara në sektorin e energjisë në Kosovë, që kanë nevojë për kontributin e profesionisteve të reja si dhe shprehin interesim për të bashkëpunuar në këtë program të aplikojnë në web faqen tonë:

millenniumkosovo.org/womeninenergy



**MILLENNIUM
FOUNDATION
KOSOVO**



MILLENNIUM
CHALLENGE CORPORATION
UNITED STATES OF AMERICA

Gratë në Energji / Programi i Punës Praktike